

VENDIM
Nr.582, datë 27.7.2011

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT PËR IDENTIFIKIMIN
DHE REFERIMIN E VIKTIMAVE/VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8920, datë 11.7.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj”, si dhe të ligjit nr.9642, datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore””, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për hartimin dhe harmonizimin e udhëzimeve përkatëse, në zbatim të këtij vendimi, duke bashkëpunuar me institucionet qendrore dhe vendore, si dhe me organizata të shoqërisë civile, me eksperiencë dhe me kontribut në luftën kundër trafikimit të personave.

3. Institucionet e ngarkuara me zbatimin e këtij vendimi të planifikojnë kostot financiare për zbatimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT PËR IDENTIFIKIMIN DHE REFERIMIN E VIKTIMAVE/VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT

1. QËLLIMI I PROCEDURAVE STANDARDE PËR IDENTIFIKIMIN DHE REFERIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Procedurat standarde të veprimit (procedurat) për identifikimin dhe referimin e viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit në zbatim të strategjisë kombëtare të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe planit të saj të veprimit, kanë për qëllim kryesor identifikimin dhe referimin në kohën dhe mënyrën e duhur të viktimave të trafikimit, të rritur apo të mitur, për të gjitha llojet e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar. Identifikimi dhe referimi i viktimave të trafikimit sipas procedurave në këtë dokument, bëhet me qëllimin kryesor mbrojtjen dhe dhënien e ndihmës, dhe pritet të kontribuojë ndjeshëm në dy shtyllat e tjera të luftës kundër trafikimit të personave, në atë të parandalimit të trafikimit dhe ndëshkimit të trafikantëve.

Procedurat parashikojnë situata në të cilat vendi ynë, Shqipëria, apo zona të caktuara të vendit, përdoren, apo mund të përdoren si vend rekrutimi, tranzitimi dhe destinacioni për shfrytëzimin e personave të trafikuar shqiptarë dhe të huaj, si edhe situata në të cilat personat e trafikuar me shtetësi shqiptare, apo të hamendësuar shqiptare ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Procedurat parakuptojnë një ndërhyrje multidisiplinore dhe zbatimi i tyre është detyrim i të gjitha institucioneve shtetërore, në nivel qendror dhe lokal që punojnë në vend apo janë me mision shtetëror jashtë vendit. Veprimi në përputhje me këto procedura është detyrim edhe i të gjitha agjencive joshetërore që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë në çdo moment në të cilin ato gjatë veprimtarisë së tyre, bien në kontakt me një person që mund të vlerësohet prej tyre apo informohet tek ata se është viktimë e trafikimit të personave. Ato, gjithashtu, parakuptojnë bashkëpunimin me strukturat analoge në vende të tjera për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Procedurat bazohen në eksperiencën e deritanishme në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit për krijimin e një mekanizmi kombëtar referimi për identifikim dhe asistencë të përmirësuar për viktimat e trafikut të qenieve njerëzore (MKR), datë 18.7.2005, eksperiencën e autoritetit përgjegjës të ngritur me urdhrin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm, të Ministrit të Jashtëm dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave të trafikimit dhe përcaktimin e detyrave të institucioneve të përfshira në këtë proces” të datës 19.5.2006, si dhe urdhrave apo udhëzimeve të tjera të mëvonshme të autoriteteve shtetërore. Procedurat janë hartuar në të njëjtën frymë me instrumentet ndërkombëtare që trajtojnë çështjet e parandalimit të trafikimit, mbrojtjes së viktimave dhe ndjekjes penale të trafikantëve, si edhe reflektojnë rekomandimet e dhëna për të njëjtën fushë veprimi nga organizma ndërkombëtare si OKB, DASH, KE, IOM, OSBE, UNICEF, ICITAP, ICMPD, UNODC etj.

Hartimi i procedurave është konsideruar i domosdoshëm për forcimin e një rrjeti funksional dhe të qëndrueshëm për rastet e trafikimit. Hartimi dhe aplikimi i procedurave mund të kontribuojë edhe në forcimin e një sistemi funksional identifikimi dhe referimi për të miturit dhe deri në njëfarë mase për të rriturit e kategorive në nevojë për kujdes dhe mbrojtje.

Procedurat janë hartuar nëpërmjet një diskutimi të gjerë me mbështetjen dhe kontributin e strukturave dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat punojnë aktivisht dhe njohin mirë fushën e parandalimit të trafikimit dhe mbrojtjes së personave të trafikuar.

2. SHKURTIMET

AP	Autoriteti Përgjegjës
A/IPIF	Agjencitë/ Institucionet Përgjegjëse për Identifikim Fillestar
DASH	DASH
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DRKM	Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit
G/SPIF	Grupi/ Struktura Përgjegjëse për Identifikim Formal
A/IPIF	Agjencitë/Institucionet Përgjegjëse për Identifikimin e Hershëm
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnim në Hetimet Penale
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit
KB	Kombet e Bashkuara
KiE	Këshilli i Europës
KRAT	Komitetet Rajonale Antitrafikim
KSHNJ	Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike
MB	Ministria e Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MD	Ministria e Drejtësisë
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të KB
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
PDRSH	Përfaqësitë Diplomatike të Republikës së Shqipërisë
PKM	Pika e Kalimit Kufitar
SLKTP	Spektori i Luftës kundër Trafikeve të Paligjshme (i Policisë)
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogat
VT	Viktimë e trafikimit
VMT	Viktimë e mundshme e Trafikimit
ZKKAT	Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim
ZRSSSH	Zyra Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror

3. PARIMET E PËRGJITHSHME MBI TË CILAT MBËSHTETEN PROCEDURA STANDARDE

- Trafikimi i personave është dhunim i të drejtave të njeriut. Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit do të jenë gjithmonë në qendër të të gjitha përpjekjeve për të parandaluar dhe luftuar trafikimin dhe për të mbrojtur, ndihmuar dhe kompensuar viktimat e trafikimit;¹

- Asnjë masë kundër trafikimit të personave nuk do të cenojë të drejtat dhe dinjitetin e njeriut, në veçanti të drejtat e personave të trafikuar, migrantëve, personave të zhvendosur, refugjatëve dhe azilkërkuesve;²

- Identifikimi dhe referimi për ndihmë i personave të trafikuar bëhet në bashkërendim dhe bashkëpunim të plotë të të gjitha autoriteteve dhe strukturave shtetërore ose joshtetërore;

- Identifikimi i viktimave të trafikimit do të bëhet jo si qëllim në vetvete por për të ndihmuar dhe mbrojtur ata/ato;

- Çdo person për të cilin/të cilën dyshohet se është viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore do të trajtohet si viktimë. Nëse nga aplikimi i procedurave gjendet se ai/ajo nuk është viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, por gjithsesi është viktimë e një veprë tjetër penale apo është një

¹ Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, (OHCHR), parime dhe udhëzime të rekomanduara për të drejtat e njeriut dhe trafikimin e njerëzve

² Po aty

person në nevojë për ndihmë, këto nevoja nuk do të injorohen, por këtyre personave do t'u jepet ndihma e duhur dhe do të referohen te shërbimet që plotësojnë nevojat e tyre;

- Personat e trafikuar ose të dyshuar si të trafikuar nuk do të burgosen, gjobiten apo dënohen për paligjshmërinë/parregullsinë e hyrjes ose të qëndrimit në vend apo për përfshirjen në aktivitete të paligjshme në rast se ka të dhëna se përfshirja ka ardhur si pasojë e drejtpërdrejtë e trafikimit të tyre;

- Personat e trafikuar do të mbrohen nga organet përkatëse nga shfrytëzimi dhe dëmtimi i mëtejshëm dhe do t'u sigurohet ndihmë e menjëhershme te kujdesi i nevojshëm;

- Ndhimja dhe mbrojtja për personat e trafikuar nuk do të kushtëzohet nga bashkëpunimi i tyre me drejtësinë;

- Kurdoherë që është e nevojshme dhe e mundshme, viktimave të trafikimit do t'u ofrohet përfshirja në programin e mbrojtjes së dëshmitarit;

- Të miturit, viktimat të trafikimit do të identifikohen si të tillë. Në çdo rast do të ruhet interesi më i lartë i të miturit/të miturës dhe do të bëhen përpjekje maksimale për ushtrimin e të drejtave të të miturve të parashikuara në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve;

- Të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me viktimat e trafikimit apo viktimat e mundshme të trafikimit do të kryhen në çdo moment duke marrë masa serioze të ruajtjes së sigurisë;

- Mbrojtja e të drejtave të njeriut të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe ndihma konkrete e dhënë do të kontribuojë në hetimin dhe penalizimin efektiv të trafikantëve dhe anasjelltas;

- Zbatimi i procedurave për identifikim dhe referim dhe ndihmë për viktimat e trafikimit do të bëhet pa asnjë lloj diskriminimi mbi seksin, racën, ngjyrën, gjuhën, besimin, bindjet politike apo të tjera, origjinën shoqërore apo kombësinë, pronën, lindjen apo çdo lloj statusi tjetër;

- Informimi për të drejtat e njeriut, të drejtat e personave të trafikuar, përfshirë të drejtën për të denoncuar trafikantët dhe të drejtën për kompensim do të jetë detyrim për të gjithë përgjegjësit e procesit në çdo hap;

- Çdo personi të identifikuar si viktimë apo viktimë e mundshme trafikimi do t'i ofrohet ndihmë dhe mbrojtje falas dhe do t'i garantohet në kohë ndihma dhe mbrojtja e zgjedhur prej tij/saj;

- Jeta private dhe identiteti i viktimave të mundshme trafikimi apo viktimave të trafikimit do të mbrohen në çdo rast. Dhënia apo marrja (shkëmbimi) e të dhënave të personit viktimë apo viktimë e mundshme e trafikimit do të bëhet me lejen e informuar të vetë personit dhe vetëm në masën që përputhet me qëllimin për të cilën bëhet shkëmbimi i të dhënave. Të dhënat personale të personave të trafikuar do të ruhen dhe do të përdoren në përputhje me Konventën e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Individëve, për sa i përket procesimit automatik të të dhënave personale, ligjit nr.9887, të datës 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"³, si edhe akteve të tjera të legjisllacionit shqiptar në fuqi;

- Identifikimi dhe referimi i viktimave të mundshme apo viktimave të trafikimit do të bëhet në kohën më të shpejtë të mundshme, duke respektuar afatet ligjore dhe shmangur dhe minimizuar vonesat, lodhjen dhe ritraumatizimin e tyre;

- Viktima apo viktimat e mundshme e trafikimit do të referohen apo vendoset në një ambient të mbrojtur e përkujdesës apo program ndihme, vetëm kur atij/asaj (nëse i mituri/e mitura edhe kujdestarit të tij/saj ligjor, të papërfshirë në trafikim) i është shpjeguar qartë ndihma që do të marrë, të drejtat dhe detyrimet që përfshin vendosja në atë vend apo përfshirja në program, dhe vetëm kur viktimat ka dhënë pëlqimin e tij/të saj të informuar për referimin, vendosjen ose përfshirjen;

- Çdo vendim i viktimës dhe i kujdestarit ligjor, nëse viktimat është i mitur/e mitur, për vendin ku dëshiron të vendoset apo të ndihmohet, si edhe për llojin e ndihmës që kërkon, do të dokumentohet gjithashtu është e mundur me shkrim.

³ Fletorja Zyrtare, viti 2008, nr. 44, faqe 2001, data e botimit 1.4.2008

4. PËRKUFIZIMET BAZË PËR PROCEDURAT.

Trafikim i personave: Sipas nenit 110/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë është “Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit”⁴.

Trafikimi i të miturve: Sipas nenit 128/b të Kodi Penal, të Republikës së Shqipërisë është “Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit”.

Viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore (VT): Sipas shkronjës “e” të nenit 4 të ligjit nr.9642, datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës” “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore” është personi objekt i trafikimit të qenieve njerëzore.

Viktimë e mundshme e trafikimit të qenieve njerëzore (VMT): Në këtë dokument është personi për të cilin/të cilën agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar gjykojnë se mund të jetë trafikuar.

Identifikim fillestar i viktimave të trafikimit: Në këtë dokument është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga institucionet shtetërore dhe joshtetërore në kufijtë dhe brenda territorit të Republikës së Shqipërisë që bën të mundur përcaktimin se një person i mitur apo i rritur është viktimë e mundshme e trafikimit të qenieve njerëzore. Këto veprime duhet të përfshijnë minimalisht: 1. vlerësimin e situatës së personave kundrejt treguesve të trafikimit; 2. mbledhjen dhe analizën e informacionit fillestar mbi procesin e trafikimit të personit; 3. informimin e personit për të drejtat dhe ndihmën në dispozicion të viktimave të mundshme të trafikimit dhe viktimave të trafikimit dhe mënyrat e qasjes të ndihmës; 4. dhënien e ndihmës së parë për ta nxjerrë personin nga rrjeti i shfrytëzimit dhe për rehabilitimin e tij/saj sa më të shpejtë në një mjedis të sigurt; 5. njoftimin e grupit/strukturës përgjegjëse për identifikim formal (G/SPIF); dhe 6. bashkëpunimin dhe koordinimin për të siguruar rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të trafikuar.

Agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar (A/IPIF): Në këtë dokument janë agjencitë apo institucionet shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për identifikimin fillestar/identifikimin e viktimave të mundshme. Ato ndahen në 3 institucione/agjenci sipas vendit ku bëhet identifikimi: 1. në kufijtë e Republikës së Shqipërisë; 2. në territorin e Republikës së Shqipërisë; dhe 3. jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në kufijtë e Republikës së Shqipërisë, agjencia përgjegjëse për identifikim fillestar është Policia e Kufirit dhe Migracionit. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, agjencitë përgjegjëse për identifikim fillestar janë agjencitë shtetërore dhe joshtetërore përfshirë: strehëzat për viktimat e trafikimit, qendrat e përkujdesjes shoqërore për persona në nevojë, organizatat me programe të ndihmës për persona në nevojë, zyrat e shërbimit social në rajone, strukturat e policisë së shtetit, inspektorati i punës, zyrat e punës, drejtoritë rajonale të arsimit/zyrat rajonale arsimore, drejtoritë rajonale të shëndetit, njësitë për mbrojtjen e fëmijëve.

Jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit me shtetësi shqiptare, janë punonjësit e përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë.

Tregues të trafikimit: Në këtë dokument janë elementet përshkruese të procesit të trafikimit që reflektojnë paraqitjen apo efektet që trafikimi është informuar se ka pasur tek individët me shtetësi shqiptare apo të huaj deri në hartimin e këtij dokumenti. Në këtë dokument treguesit janë të ndarë në dy kategori: tregues parësorë të trafikimit dhe tregues dytësorë të trafikimit. Nëse te situata

⁴ Shih tek anekset nenin 114/b për trafikimin e femrave

e një personi të mitur apo të rritur konstatohen një apo më shumë tregues parësorë si elemente përbërëse të trafikimit, dhe disa tregues dytësorë që mund të interpretohen si pasoja të procesit të trafikimit, personi do të konsiderohet viktimë e mundshme e trafikimit/person që mund të jetë trafikuar apo që po trafikohet. Këta tregues janë vënë në dispozicion këtu për lehtësimin e identifikimit fillestar në kufi dhe brenda territorit. Të gjitha institucionet shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për identifikimin fillestar të viktimave të trafikimit inkurajohen të mos i konsiderojnë këta tregues si një listë shteruese e paraqitjes së trafikimit dhe pasojave të tij, por të përdorin gjykimin e tyre profesional dhe të rifreskojnë në mënyrë të vazhdueshme njohuritë e tyre mbi çdo prirje të paraqitjes së trafikimit dhe efekteve të tij mbi personat në komunitetet ku punojnë.

Identifikimi formal i viktimave të trafikimit në kufijtë dhe territorin e Republikës së Shqipërisë: Në këtë dokument është identifikimi i një personi si viktimë trafikimi i kryer vetëm nga grupi/struktura përgjegjëse për identifikim formal (G/SPIF) në bazë të formatit të intervistës formale të përfshirë në këtë dokument. Identifikimi formal duhet të arrijë minimalisht: 1. përcaktimin nëse personi është viktimë e trafikimit, nëpërmjet mbledhjes dhe analizës së informacionit të dhënë nga vetë personi; 2. vlerësimin në mënyrë të thelluar të nevojave të personit viktimë e trafikimit për ndihmë dhe mbrojtje; 3. dhënien e udhëzimeve dhe sigurimin e qasjes së personit të trafikuar te ndihma e përshtatshme dhe e sigurt; 4. grumbullimin e informacionit dhe nisjen e hetimeve për penalizimin e trafikantëve. Intervista formale dhe të gjitha veprimet për përcaktimin e statusit të personit në lidhje me trafikimin, kryhet në kohën më të shpejtë të mundshme pas identifikimit të personit si viktimë e mundshme e trafikimit të qenieve njerëzore. Intervista formale kryhet veçmas në kohë nga kallëzimi. Edhe nëse personi dëshiron të bëjë kallëzim, në asnjë rast, intervista formale nuk ndërpritet për të marrë kallëzimin, por caktohet një kohë tjetër.

Intervista formale kryhet në çdo rast në ambientet e intervistimit të policisë së SLKTP-së, dhe të gjitha organizimet e nevojshme për kryerjen e intervistës formale, përfshirë njoftimin e punonjësit social shtetëror janë përgjegjësi e punonjësit të policisë së SLKTP-së.

Identifikimi formal i viktimave të trafikimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë: Në këtë dokument do të konsiderohet kërkesa për informacion e autoritetit përgjegjës për identifikimin dhe ndihmën e viktimave të trafikimit me shtetësi shqiptare nga autoritetet vendase me tagër për identifikimin e personave të trafikuar.

Grupi/struktura përgjegjëse për identifikimin formal në kufijtë dhe territorin e Republikës së Shqipërisë (G/SPIF): Në këtë dokument është grupi/struktura që kryen intervistimin formal të personave që njoftohen si viktima të mundshme të trafikimit e përbërë nga një punonjës i policisë së shtetit i seksionit të luftës kundër trafikëve të paligjshme (SLKTP) dhe një punonjës social shtetëror i zyrës rajonale të shërbimit social shtetëror (ZRSSSH) që ushtrojnë funksionet e përcaktuara në bazë të ligjit në rajonin/qarkun ku ndodhet aktualisht personi që do të identifikohet formalisht.

Autoriteti përgjegjës për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave të trafikimit (AP): Është strukturë e ngritur me urdhrin e përbashkët të Ministrisë të Brendshme, Ministrisë të Jashtëme dhe Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave të trafikimit dhe përcaktimin e detyrave të institucioneve të përfshira në këtë proces”, të datës 19.5.2006. Autoriteti përgjegjës përbëhet nga dy përfaqësues të ministrive nënshkruese të urdhrin për ngritjen e tij. Funksionet e përgjithshme të autoritetit përgjegjës sipas këtij urdhri janë:

a) të bashkërendojë dhe të mbikëqyrë me strukturat qeveritare dhe joqeveritare në Shqipëri, identifikimin dhe referimin për ndihmë dhe riintegrim të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit;

b) të bashkërendojë me strukturat përkatëse në vendet e destinacionit, identifikimin, procesin e kthimit vullnetar dhe referimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit me nënshtetësi shqiptare;

c) të bashkërendojë mbrojtjen dhe kthimin e asistuar të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit me nënshtetësi të huaj të identifikuar në Shqipëri;

d) të ndërtojë dhe të përditësojë një bazë të dhënash për viktimat e referuara, t'i raportojë rregullisht koordinatorit kombëtar të antitrafikut rreth të dhënave të mbledhura dhe të zhvillojë mbledhje të rregullta me palët qeveritare dhe joqeveritare të mekanizmit kombëtar të referimit.

Ndihmë e pakushtëzuar për viktimat e trafikimit: Sipas nenit 12 të Konventës së Këshillit të Europës për veprim kundër trafikimit të personave, ndihma për viktimat e trafikimit, nuk kushtëzohet nga dëshira e viktimës për të dëshmuar, ajo jepet në përgjigje të nevojave të viktimave dhe përfshin minimalisht: strehim të përshtatshëm dhe të sigurt, ndihmë psikologjike dhe materiale, qasje te trajtimi mjekësor i menjëhershëm, përkthim kur është e nevojshme, këshillim dhe informacion, sidomos për të drejtat ligjore, ndihmë për paraqitje dhe marrje në konsideratë gjatë procedimit të trafikantëve, qasje në shkollim, trajnim profesional dhe punësim. Të gjitha shërbimet për viktimat e trafikimit ofrohen dhe jepen në një gjuhë të kuptueshme.

I/e mitur: Në përputhje me legjislacionin shqiptar penal dhe civil, i/e mitur është çdo person nën moshën 18 vjeç.

Dëshmitar i drejtësisë: Sipas nenit 3 të ligjit nr.10 173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë” është personi i cili, në cilësinë e dëshmitarit apo personit të dëmtuar bën deklaratime a dëshmon për fakte e rrethana, që përbëjnë objekt prove në një procedim penal dhe që për shkak të këtyre deklaratimeve e dëshmimeve, ndodhet në një gjendje rreziku.

Trafikant i qenieve njerëzore: Është çdo person i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Krimeve të Rënda për veprën penale të trafikimit të personave, apo çdo person tjetër shqiptar apo i huaj i dënuar nga një gjykatë kompetente për kryerjen e veprës penale të trafikimit.

Prind: Sipas nenit 3 “Përkufizime” të ligjit nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, është personi/personat që e kanë lindur ose e kanë birësuar fëmijën të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese.

Përfaqësues ligjor i fëmijës: Sipas nenit 3, “Përkufizime”, të ligjit nr.10 347, është kujdestari ose familja kujdestare, personi apo institucioni, i cili, brenda targeve që i janë dhënë nga ligji ose nga gjykata, mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës.

Vendim i informuar: Vendim i marrë nga një person për përfshirjen ose jo të tij/saj në një procedurë të vlerësimit të nevojave të tij/saj, marrjen ose jo të një shërbimi që plotëson nevojat e tij/saj, vetëm pasi personi është informuar në mënyrë të plotë për procedurën, shërbimin, dhe alternativat e tjera për vlerësimin dhe plotësimin e nevojave të tij/të saj.

Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve: Sipas nenit 298 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, është strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit, ose i mjeteve të tjera të transportit apo çdo ndihmë tjetër me qëllim kalimin e paligjshëm të kufirit të Republikës së Shqipërisë ose për hyrjen e paligjshme të një personi në një shtet tjetër pa qenë shtetas i tij ose që nuk ka leje qëndrimi në atë shtet.

I/e mitur i/e pashoqëruar: Sipas pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008, është i mituri nën 18 vjeç, i cili ka ardhur në Shqipëri i pashoqëruar nga prindërit ose kujdestari i vet ligjor apo nga ndonjë anëtar tjetër i familjes.⁵

Azilkërkues: Sipas pikës 2 të nenit 3 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt” është i huaji, që kërkon azil për njërin nga arsytet e parashikuara në ligjin nr.8432, datë 14.12.1998 “Për azilin”⁶.

Regjistri kombëtar për të huajt: Sipas pikës 26 të nenit 3 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt” është dokumenti zyrtar, që ndodhet pranë autoriteteve përgjegjëse shtetërore, me të dhënat e hollësishme të të huajve, për hyrjen, qëndrimin, lëvizjen, punësimin në Republikën e Shqipërisë.

Leje qëndrimi: Sipas pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt” është leja e lëshuar nga autoritetet kompetente, e cila lejon të huajin të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë. Sipas nenit 31, “Pajisja me leje qëndrimi në raste përjashtimore” të këtij ligji, për motive humanitare viktimat e trafikimit pajisen me leje të përkohshme qëndrimi për efekt mbrojtje të përkohshme.

⁵ http://asp.gov.al/mpo/ligjet/ligji_per_te_huajt.htm

⁶ http://asp.gov.al/mpo/ligjet/ligji_per_te_huajt.htm

Leje pune: Sipas pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt” është autorizimi i lëshuar nga autoriteti shtetëror përgjegjës një të huaji, për qëllime biznesi, për t’u punësuar, vetëpunësuar ose për formim profesional. Sipas nenit 60 të këtij ligji, të huajt viktimë e mundshme e trafikimit ose viktimë e trafikimit i jepet leje pune për raste të veçanta e tipit “C” deri në një vit.

Shërbime shoqërore: Sipas nenit 4 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” janë tërësia e shërbimeve që u ofrohet individëve dhe grupeve në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të përballojnë me burimet që kanë nevojat e tyre jetësore, për ruajtjen, dhe zhvillimin e mundësive individuale, për të kapërcyer nevojat emergjente apo kronike. Sipas neneve 12, 13, 14 dhe 15 të po këtij ligji, shërbimet shoqërore, ndahen sipas natyrës, në shërbime të përkujdesit shoqëror dhe shërbime të përkujdesit shoqëror-mjekësor. Shërbimet e përkujdesit shoqëror përfshijnë shërbimet që u ofrohen individëve, familjeve, grupeve në nevojë, komuniteteve për plotësimin e nevojave të tyre jetësore. Shërbimet e përkujdesit shoqëror-mjekësor ofrohen nga personeli i specializuar në qendra riintegruese dhe rehabilituese rezidenciale, qendra ditore apo familje, për individët, të cilët nuk janë në gjendje të jetojnë normalisht, për shkak të përkeqësimeve të përkohshme apo të përhershme fizike, psikike mendore dhe sensore. Shërbimet e përkujdesit shoqëror, sipas mënyrës së organizimit dhe funksionimit, janë shërbime të përkujdesit rezidencial dhe shërbime të përkujdesit komunitar. Shërbimet në institucione rezidenciale ofrohen për individë, për të cilët përkujdesi në shtëpi nuk është i mundur. Vendosija e tyre në qendrat e përkujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e personit apo përfaqësuesit të tij ligjor, pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të tij. Shërbimet e përkujdesit komunitar ofrohen në qendra ditore, shtëpitë e individëve apo në familjen kujdestare, sipas nevojave specifike të grupeve përfutuese. Krahas shërbimeve të përkujdesit komunitar grupeve dhe individëve në nevojë u ofrohet edhe shërbimi arsimor, sidomos ai i detyruar.

Ndihmë ekonomike: Sipas nenit 4 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” ka kuptimin e mbështetjes në para e në natyrë të individëve me status të veçantë dhe e familjeve në nevojë. Sipas nenit 1 të ligjit nr.10 252, datë 11.3.2010 “Për disa shtesa në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, viktimat e trafikimit përfshihen në përfutuesit e ndihmës ekonomike pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre.

Strehëzat/qendrat për viktimat e trafikimit: Janë institucione rezidenciale shtetërore ose joshtetërore të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për të dhënë shërbime ndihme dhe mbrojtjeje për personat viktimat të mundshme, viktimat e trafikimit dhe persona në rrezik trafikimi. Strehëzat/qendrat mund të jenë të hapura ose të mbyllura, mund të ofrojnë qëndrim afatshkurtër ose afatgjatë; dhe/ose përdoren për rastet e emergjencave ose të mbështetjes për riintegrim. Qendrat mund të emërtohen pritëse, riintegruese apo pritëse-riintegruese). Ofrimi dhe dhënia e shërbimeve në strehëza bëhet në përputhje me vendim të Këshillit të Ministrave nr.195, datë 11.4.2007 “Për miratimin e standardeve të përkujdesit shoqëror në qendrat rezidenciale për personat e trafikuar dhe në rrezik trafikimi”.

Baza e të dhënave TIMS: Sistemi Total i Menaxhimit të Informacionit (TIMS), është një sistem të dhënash përmes të cilit bëhet përpunimi i të gjitha të dhënave, që përfshin hedhjen e të dhënave të shërbimit kufitar, trafikimit të personave, lidhjen *online* me të 12-të Drejtoritë e Policive në Qarqe, dhe monitorimin në 24 orë të të 24 pikave kufitare me kamera nga Policia e Shtetit.

Baza e të dhënave për viktimat e trafikimit: Është një bazë të dhënash e integruar në sistemin TIMS, i cili është i vetmi burim zyrtar për statistikat në lidhje me viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit.

Kallëzimi: Është referimi i fakteve që lidhen me veprën penale. Kallëzimi i viktimës së trafikimit të mitur e të rritur si persona të dëmtuar nga vepra penale, është vullnetar, dhe bëhet sipas përcaktimeve specifike të Kodit të Procedurës Penale.

Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) është institucion ekzekutiv i politikave dhe legjislacionit në fushën e mbrojtjes sociale në Shqipëri. SHSSH është një agjenci shtetërore dhe vepron në vartësi të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Statuti përcakton funksionet bazë dhe përmbajtjen e aktivitetit institucional të SHSSH-së në tri fushat kryesore të veprimtarisë: ndihmës

ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve të përkujdesit social.

Menaxheri i rastit: Në këtë dokument është punonjësi social i caktuar me qëllim dhënien e ndihmës dhe ndërmjetësimin për ndihmë për VT apo VMT. Menaxheri i rastit vepron brenda një grupi këshillimor me profesionistë të tjerë, kur duhet të merren vendime mbi planin e përkujdesjes për secilën person. Menaxheri i rastit në rastin e VT apo VMT mund të jetë punonjësi social i Zyrës Rajonale të Shërbimit Social ose punonjësi social i qendrës pritëse apo rehabilituese për viktimat e trafikimit.⁷

5. KUADRI LIGJOR KU MBËSHTETEN NË MËNYRË TË VEÇANTË PROCEDURAT⁸

Legjislacioni ndërkombëtar:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
 - Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Individëve, për sa i përket përpunimit automatik të të dhënave personale;
 - Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës;
 - Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;⁹
 - Protokollin shtesë i Konventës për të Drejtat e Fëmijës për Shitjen e Fëmijës, Prostitucionin e Fëmijës dhe Pornografinë e Fëmijës;¹⁰
 - Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional/ “Protokollin Shtesë mbi parandalimin, shtypjen, dhe ndëshkrimin e trafikimit të personave, në mënyrë të veçantë të grave dhe fëmijëve”;¹¹
 - Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional/“Protokollin kundër Kontrabandimit të Emigrantëve në Rrugë Tokësore, Ajrore dhe Detare”¹². Konventa e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave CEDAW;
 - Konventa e Këshillit të Europës “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”;¹³
 - Protokollin Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijës “Mbi shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve”;
 - Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore, datë 24.4.1963 Konventa e Konferencës së Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit” (aderuar me ligjin nr.8624, datë 24.6.2000);
 - Konventa e Konferencës së Hagës “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve” (aderuar me ligjin nr.9443/2005);
 - Konventa e Konferencës së Hagës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve” (aderuar me ligjin nr.9446/2005);
 - Konventa e Konferencës së Hagës “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore” (aderuar me ligjin nr.10 397, datë 17.3.2011);
 - Konventa e Konferencës së Hagës “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore” (aderuar me ligjin nr.10 398, datë 17.3.2011);
 - Konventa e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit dhe abuzimeve seksuale” (ratifikuar me ligjin nr.10 071, datë 9.2.2009);
 - Konventa e Këshillit të Europës “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës” (ratifikuar me ligjin nr.10 424, datë 2.6.2011);
- Konventa e Këshillit të Europës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve” (ratifikuar me ligjin nr.10 425, datë 2.6.2011);

⁷ Përshtatur nga TRM

⁸ Për tekstin e plotë të neneve kundër trafikimit në njerëz dhe veprave penale të lidhura me të, referojuni aneksit 1

⁹ Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për Ratifikimin e Konventës Europiane “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, Fletorja Zyrtare nr. 20, viti i botimit 1996

¹⁰ Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.9834, datë 22.11.2007 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Fëmijëve, Për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë me Fëmijë” Fletorja Zyrtare nr.165, viti i botimit 2007

¹¹ Ligji nr.8920, datë 11.7.2002, Fletore Zyrtare nr.41, korrik 2002

¹² www.uncj.org/documents/conventions

¹³ Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.9642, datë 20.11.2006 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”, Fletorja Zyrtare nr.132, viti i botimit 2006

- Konventa e Konferencës së Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes” (miratuar në parim, nga Këshilli i Ministrave, në mbledhjen e datës 26.5.2011).

Legjislacioni vendas:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë¹⁴;
- Kodi Penal, dhe Kodi i Procedurës Penale;
- Kodi Civil dhe Kodi i Procedurës Civile;
- Kodi i Familjes;
- Ligji nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar, i cili parashikon rregulla për realizimin me sukses të procedurave të birësimit të fëmijëve, duke ndikuar kështu edhe në shmangien e rasteve të trafikimit të fëmijëve;
- Ligji nr.10 193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, në të cilin parashikohen rregullat mbi forcimin e bashkëpunimit gjyqësor për çështjet penale, përfshirë edhe ato të trafikimit;
- Ligji nr.8677, datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar së fundmi me ligjin nr.10 301, datë 15.7.2010, i cili synon të forcojë marrëdhënien polici gjyqësore-prokurori me qëllim rritjen e efikasitetit të luftës kundër krimit të organizuar përfshirë edhe trafikimin;
- Ligji i ri për ndërmjetësimin, ligji nr.10 385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, në të cilin parashikohet se gjykata ose organi përkatës shtetëror, brenda kompetencave të parashikuara në ligj, detyrimisht ftojnë palët për zgjidhjen me ndërmjetësim, veçanërisht për mosmarrëveshjet në çështjet civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve.

Më specifikisht në legjislacionin vendas është marrë në konsideratë:

- Kodi Penal neni 110/a “Trafikimi i njerëzve”;
- Kodi Penal, neni 114/b “Trafikimi i femrave”;
- Kodi Penal, neni 128/b “Trafikimi i të miturve”;
- Kodi Penal, neni 298 “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”;
- Kodi Penal, neni 124/b “Keqtrajtimi i të miturit”;
- Kodi Penal, neni 117 “Pornografia”;
- Ligji nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”¹⁵;
- Ligji nr.8920, datë 11.7.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional dhe dy protokolleve shtesë”;
- Ligji nr.9265, datë 29.7.2004 “Për ratifikimin e Konventës Europiane “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme””;
- Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”¹⁶;
- Ligji nr 9749, datë 11.4.2007 “Për Policinë e Shtetit”;
- Ligji nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”¹⁷;
- Ligji nr.9095, datë 3.7.2003 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr.10 173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”;
- Ligji nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”;
- Ligji nr.10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën Juridike”;
- Ligji nr.10 252, datë 11.3.2010 “Për disa shtesa në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar¹⁸;
- Ligji nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”;

¹⁴ Për tekstin e plotë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, shihni <http://www.president.al/shqip/kushtetuta.asp>

¹⁵ Fletorja Zyrtare nr.14, viti i botimit 2000

¹⁶ Fletorja Zyrtare nr.150, viti i botimit 2006

¹⁷ Fletorja Zyrtare, nr.124, viti i botimit 2008

¹⁸ Fletorja Zyrtare, nr.4, viti i botimit 2010

- Urdhri i përbashkët i Ministrisë të Brendshme, Ministrisë të Jashtëme dhe Ministrisë të Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave të trafikimit dhe përcaktimin e detyrave të institucioneve të përfshira në këtë proces” të datës 19.5.2006;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.195, datë 11.4.2007 “Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi në Qendrat Rezidenciale”¹⁹;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.933, datë 2.7.2008 “Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë dhe Europol”;

- Udhëzimi i Ministrisë të Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nr.316, datë 10.2.2010 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”²⁰;

- Urdhërshërbimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr.871, datë 27.12.2007 “Për procedurat që kryhen në kufi për intervistimin e shtetasve të huaj dhe shqiptarë të kthyer nga vendet e tjera”²¹;

- Udhëzimi i Ministrisë të Brendshme, nr.1085, datë 12.6.2006 “Për Procedurat që duhet të zbatohet Policia e Shtetit për përzgjedhjen e të huajve të parregullt”;

- Marrëveshja e Bashkëpunimit për krijimin e një mekanizmi kombëtar referues për identifikim dhe asistencë të përmirësuar për viktimat e trafikut të qenieve njerëzore (MKR) e firmosur më datë 18 korrik 2005;

- Memorandumi i Mirëkuptimit i Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Europë në Shqipëri (OSCE) “Për promovimin dhe zbatimin e Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Turizëm”²².

6. SHPJEGIME TË PËRGJITHSHME MBI PROCEDURAT DHE ORGANIZIMIN E MËTEJSHËM TË DOKUMENTIT

Për strukturimin e dokumentit të procedurave janë marrë parasysh tri situatat apo vendet në të cilat mund të nisë identifikimi dhe nga mund të referohet që janë përkatësisht kufijtë e Republikës së Shqipërisë, në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ndarja 7: Procedurat nëndahen më tej në: 7.1 procedurat që nisin në kufi; 7.2 procedurat që nisin në territorin e Republikës së Shqipërisë; 7.3 procedurat jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Procedurat që nisin në kufi dhe në territor synojnë identifikimin referimin dhe ndihmën e VT dhe VMT me shtetësi shqiptare dhe të huaj. Procedurat jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë synojnë identifikimin, referimin dhe ndihmën e VT dhe VMT me shtetësi shqiptare.

Një element tjetër i përdorur për strukturimin e procesit të identifikimit dhe referimit është ndarja e procesit të identifikimit si identifikim fillestar/identifikimi i viktimës së mundshme (VMT), dhe identifikimi formal/identifikimi i viktimës së trafikimit (VT). Për këtë arsye nëndarjet 7.1, 7.2 dhe 7.3 janë secila të ndara më tej në dy pjesë/tabela. Kjo ndarje e procesit dhe kategorizimet që rrjedhin prej saj, VMT dhe VT, bëhet me qëllim që të shfrytëzohet çdo mundësi kontakti me personat e trafikuar për t’i ndihmuar ata/ato sa më shpejt që është e mundur, të rritet përgjegjësia institucionale për identifikimin dhe ndihmën ndaj personave të trafikuar, dhe të fokusohet identifikimi te vlerësimi i thelluar dhe adresimi shumëdisiplinor i nevojave të viktimave të trafikimit në kushtet e sigurisë dhe me pjesëmarrjen aktive të vetë viktimave. Përcaktimi se një person është

¹⁹ <http://mpcs.gov.al/strategji-standarte>

²⁰ Fletorja Zyrtare nr.19, 2010

²¹ Raporti i vlerësimit për zbatimin e strategjisë kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007, hartuar nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Trafikimin në Njerëz

<http://www.moi.gov.al/images/pdf/buletini/RaportiVleresuesStrategjiseKombetareAntitrafikim2005-2007.pdf>

²² Raporti i vlerësimit për zbatimin e strategjisë kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007, hartuar nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Trafikimin në Njerëz. Tekstin e plotë të këtij raporti mund ta gjeni në <http://www.moi.gov.al/images/pdf/buletini/RaportiVleresuesStrategjiseKombetareAntitrafikim2005-2007.pdf>

“viktimë e mundshme e trafikimit (VMT)” nuk do të thotë në asnjë mënyrë se personi nuk është trafikuar, ky përcaktim do të thotë vetëm që personi nuk është identifikuar se është “viktimë trafikimi (VT)” nga grupi/struktura përgjegjëse për identifikim formal në kufi dhe territor (G/SPIF).

Pra, pavarësisht nga këto kategorizime, të gjithë personave qofshin të identifikuar si viktima të mundshme nga institucionet që bëjnë identifikimin fillestar, apo qofshin persona të identifikuar si viktima trafikimi nga struktura përgjegjëse për identifikim formal do t’u sigurohet akses i menjëhershëm te ndihma e nevojshme.

Identifikimi fillestar (i VMT të huaja dhe shqiptare) në kufi do të bëhet nga Policia Kufitare dhe Migracionit. Përshkrimi i hollësishëm i procedurave që duhet të ndjekë kjo agjenci shtetërore dhe treguesit që duhet të përdorë jepen në ndarjen 7 “Procedurat”, në tabelën 7.1.1.

Identifikimi fillestar (i VMT të huaja dhe shqiptare) në territor do të bëhet nga shumë institucione shtetërore dhe joshtetërore të cilave në dokument u referohet me A/IPIF. A/IPIF përmbledh strukturat e policisë së shtetit, strehëzat për viktimat e trafikimit, qendrat e përkujdesjes shoqërore për persona në nevojë, organizatat me programe të ndihmës për persona në nevojë, zyrat e shërbimit social në rajone, organizatat ndërkombëtare që kanë programe kundër trafikimit të personave, inspektorati i punës, zyrat e punës, njësitë për mbrojtjen e fëmijëve.

Përshkrimi i hollësishëm i procedurave që duhet të ndjekin A/IPIF dhe treguesit që duhet të përdorin jepen në ndarjen 7 “Procedurat” në tabelën 7.2.1.

Identifikimi fillestar (i VMT shqiptare) jashtë territorit do të bëhet nga punonjësit e përfaqësive Diplomatike të Republikës së Shqipërisë. Përshkrimi i hollësishëm i procedurave që duhet të ndjekë kjo agjenci shtetërore jepet në ndarjen 7 “Procedurat” në tabelën 7.3.1. Treguesit që duhet të përdorë kjo agjenci janë të njëjta me treguesit në territor.

Identifikimi formal (i VT të huaja dhe shqiptare) në rajonet kufitare do të bëhet nga G/SPIF (një oficer i policisë gjyqësore i Sektorit të Luftës Kundër Trafiqueve të Paligjshme dhe një punonjës social shtetëror i zyrës rajonale të shërbimit social shtetëror) në rajonin kufitar. Përshkrimi i hollësishëm i procedurave që duhet të ndjekë G/SPIF-ja në rajonin kufitar jepen në ndarjen 7 “Procedurat” në tabelën 7.1.2.

Identifikimi formal (i VT të huaja dhe shqiptare) në rajonet e tjera të territorit të Republikës së Shqipërisë do të bëhet nga G/SPIF (një oficer i policisë gjyqësore i sektorit të luftës kundër trafiqueve të paligjshme dhe një punonjës social shtetëror i zyrës rajonale të shërbimit social shtetëror) i qarkut ku ndodhet personi që kërkon të identifikohet. Përshkrimi i hollësishëm i procedurave që duhet të ndjekë G/SPIF në territor jepen në ndarjen 7 “Procedurat” në tabelën 7.2.2.


Identifikimi formal (i VT shtetas shqiptarë) jashtë territorit do të bëhet nga autoriteti përgjegjës. Përshkrimi i hollësishëm i procedurave që duhet të ndjekë AP për identifikimin formal jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë jepen në ndarjen 7 “Procedurat” në tabelën 7.3.2.

Duke qenë se ndihma rehabilituese dhe ri/integruese për viktimat e trafikimit përfshin një gamë të gjerë shërbimesh të cilat janë, në pjesën më të madhe të standardizuara nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr.195, datë 11.4.2007 “Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale, në ndarjen 8 të dokumentit/ndihma, përshkruhen hapat standardë që duhet të ndiqen për kthimin vullnetar dhe ndjekjen e rasteve në komunitet/familje.


Së fundmi, siç përshkruhet në ndarjen 7 “Procedurat” dhe ndarjen 8 “Ndihma”, autoriteti përgjegjës do të jetë në çdo moment të dhënë i mirinformuar dhe i angazhuar plotësisht për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e ndihmën e çdo rasti, si edhe për hedhjen e të dhënave në bazën e të dhënave për viktimat e trafikimit në kohën më të shpejtë të mundshme. Për këtë arsye në këtë dokument janë parashikuar disa lloje njoftimesh dhe konsultimesh me autoritetin përgjegjës, si p.sh., njoftimi i autoritetit përgjegjës nga struktura që bën identifikimin fillestar të viktimave të mundshme dhe jep ndihmën e parë tek ata/ato, relacioni tek autoriteti përgjegjës nga ana e strukturës përgjegjëse për identifikim formal, njoftimi i autoritetit përgjegjës për largimin e papritur ose çdo plan për lëvizje apo transferim të viktimës apo viktimës së mundshme nga programi apo rezidenca ku është vendosur.

Më poshtë jepen tre grafikë që ilustrojnë ndarjet 7 dhe 8 të dokumentit.


Grafiku 1: Identifikimi i viktimave që nis në kufi



Grafiku 2: Identifikimi i viktimave që nis në territor



Grafiku 3: Identifikimi i viktimave që nis jashtë territorit



Në ndarjen 9 të dokumentit “Aneksë” vihen në dispozicion formate të gatshme të intervistave formale dhe dokumentacionit që duhet hartuar e mbajtur gjatë procesit të identifikimit dhe referimit, si edhe disa udhëzime specifike të gjykuara edhe ato të nevojshme për të kuptuar dhe zbatuar procedurat.

Në ndarjen 10 “Ligjet” të dokumentit jepen më të plota disa nga ligjet kryesore, me të cilat dënohet trafikimi dhe vepra të lidhura me të dhe asistohen viktimat e mundshme dhe viktimat e

trafikimit.

7. PROCEDURAT

7.1 Procedurat që nisin në kufi

7.1.1 Identifikimi dhe referimi fillestar në kufi

	Identifikimi fillestar i të miturve në kufijtë e Republikës së Shqipërisë (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi fillestar i të rriturve në kufijtë e Republikës së Shqipërisë (të huaj dhe shqiptarë)
Qëllimi	Të identifikohen të miturit viktimë të mundshme të trafikimit (VMT), nëpërmjet vlerësimit të situatës së personit të mitur, elementeve të sjelljes dhe gjendjes së tij fizike, mendore, sociale dhe ekonomike, t'u jepet të miturve informacion për të drejtat dhe ndihmën në dispozicion të viktimave të trafikimit dhe mënyrat e qasjes te ndihma, t'i jepet të miturit/të miturës ndihmë e parë për t'i nxjerrë nga rrjeti i shfrytëzimit dhe për rehabilitimin e tij/saj sa më të shpejtë në një mjedis të sigurt, dhe të njoftohet grupi/struktura përgjegjëse për identifikim formal (G/SPIF)	Të identifikohen viktimat e mundshme të trafikimit (VMT) të rritur, nëpërmjet vlerësimit të situatës së personit/elementeve të sjelljes dhe gjendjes së tij/saj fizike, mendore, sociale dhe ekonomike, t'u jepet atyre informacion për të drejtat dhe ndihmën në dispozicion të viktimave të trafikimit dhe mënyrat e qasjes te ndihma, t'u jepet viktimave të mundshme ndihmë e parë për t'i nxjerrë nga rrjeti i shfrytëzimit dhe për rehabilitimin e tij/saj sa më të shpejtë në një mjedis të sigurt, dhe të njoftohet struktura përgjegjëse për identifikim formal (G/SPIF)
Treguesit e suksesit	Numri i të miturve të identifikuar si viktimë të mundshme dhe të referuar te G/SPIF-ja	Numri i personave të rritur të identifikuar si viktimë të mundshme dhe të referuar te G/SPIF-ja
Metoda e identifikimit	Intervistë kundrejt listës së treguesve	Intervistë kundrejt listës së treguesve
Përgjegjës i drejtpërdrejtë/kush e bën	Punonjësi i policisë së kufirit dhe migracionit (PKM) në drejtorinë rajonale të kufirit dhe migracionit (DRKM) (me ndihmën e një përkthyesi nëse i mituri/e mitura është i/e huaj)	Punonjësi i policisë së kufirit dhe migracionit (PKM) në drejtorinë rajonale të kufirit dhe migracionit (DRKM) (me ndihmën e një përkthyesi nëse personi është i/e huaj)
Monitorues i drejtpërdrejtë i procesit	Përgjegjësi i turnit i pikës së kalimit të kufirit (PKK)	Përgjegjësi i turnit i pikës së kalimit të kufirit (PKK)
Koha	30 minuta (60 minuta për të miturin/të miturën i/e huaj duke dhënë gjysmën e kohës për përkthim)	30 minuta (60 minuta për personin i/e huaj duke dhënë gjysmën e kohës për përkthim)
Vendi i identifikimit	Ambientet e PKK-së për intervistimin e të miturve	Ambientet e PKK-së për intervistim
Dokumentimi i procesit	Marrëveshja e konfidencialitetit me përkthyesin (për të	Marrëveshja e konfidencialitetit me përkthyesin (për personin

	Identifikimi fillestar i të miturve në kufijtë e Republikës së Shqipërisë (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi fillestar i të rriturve në kufijtë e Republikës së Shqipërisë (të huaj dhe shqiptarë)
	miturin/të miturën i/e huaj aneksi 9.1)	i/e huaj aneksi 9.1)
	Komunikata ditore e punës	Komunikata ditore e punës
	Shënimi në regjistrin kombëtar për të huajt (për të miturin/të miturën i/e huaj aneksi 9.1)	Shënimi në regjistrin kombëtar për të huajt (për personin i/e huaj) Të dhënat e hedhura në TIMS
	Të dhënat e hedhura në TIMS	
	Listë e azhurnuar kontaktesh të punonjësve të policisë SLKTP. Listë zyrtare e azhurnuar e përkthyesve	Listë e azhurnuar kontaktesh të punonjësve të policisë SLKTP. Listë zyrtare e azhurnuar e përkthyesve
Hapat	1. Në rast se në kontaktin e parë me të miturin punonjësi i DRKM/intervistuesi në turn i PKK-së, konstaton tregues të trafikimit (shih listën e treguesve më poshtë) çon të miturin/të miturën në ambientet e përshtatshme për intervistim	1. Në rast se në kontaktin e parë me personin, punonjësi i DRKM/intervistuesi në turn i PKK-së, konstaton tregues të trafikimit (shih listën e treguesve më poshtë) shoqëron personin në ambientet e përshtatshme për intervistim
	2. Punonjësi i DRKM-së siguron që të miturit/të miturës t'i plotësohen nevojat bazë (ushqim, ujë, tualet, ngrohje, siguri fizike)	2. Punonjësi i DRKM-së siguron që personit t'i plotësohen nevojat bazë (ushqim, ujë, tualet, ngrohje, siguri fizike)
	Në rast se konstaton se i mituri/e mitura ka nevojë për ndihmë të menjëhershme mjekësore, punonjësi i DRKM-së e çon atë menjëherë në qendrën më të afërt shëndetësore	Në rast se konstaton se personi ka nevojë për ndihmë të menjëhershme mjekësore, punonjësi i DRKM-së e çon atë menjëherë në qendrën më të afërt shëndetësore
	Në rast se i/e mitura është i/e huaj, punonjësi i DRKM-së kërkon prezencën e përkthyesit nga lista e miratuar e përkthyesve dhe nënshkruan me të marrëveshjen e konfidencialitetit (aneksi 9.1)	Në rast se personi është i/e huaj, punonjësi i DRKM kërkon prezencën e përkthyesit nga lista e miratuar e përkthyesve dhe nënshkruan me të marrëveshjen e konfidencialitetit (aneksi 9.1)
	3. Punonjësi i DRKM-së interviston të miturin/të miturën dhe bën vlerësimin e parë të nevojave të të miturit përfshirë vlerësimin e rrezikut nëse ka, nga familjarët e të miturit/të miturës apo persona të tjerë	3. Punonjësi i DRKM-së interviston personin dhe bën vlerësimin e parë të nevojave të personit dhe vlerësimin e rrezikut nëse ka nga persona të tjerë
	4. Në rast se konstaton se i	4. Në rast se konstaton se

	Identifikimi fillestar i të miturve në kufijtë e Republikës së Shqipërisë (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi fillestar i të rriturve në kufijtë e Republikës së Shqipërisë (të huaj dhe shqiptarë)
	mituri/e mitura është viktimë e mundshme e trafikimit (VMT), punonjësi i DRKM-së, njofton menjëherë punonjësën e policisë së SLKTP-së	personi është viktimë e mundshme e trafikimit (VMT), punonjësi i DRKM-së, njofton menjëherë punonjësën e policisë së SLKTP-së
	Në rast se konstaton se i mituri/e mitura nuk është VMT por, gjithsesi, një i mitur/e mitur në nevojë për ndihmë e mbrojtje, punonjësi i DRKM-së njofton menjëherë përgjegjësën e turnit dhe së bashku njoftojnë drejtuesin e radhës të AP-së dhe konsultohen me të për hapat e mëtejshëm që duhet të ndjekin	
	5. Punonjësi i DRKM-së e informon punonjësën e policisë së SLKTP-së mbi të dhënat e mbledhura mbi trafikimin e të miturit/të miturës, përfshirjen ose jo të familjes në trafikimin e mundshëm dhe nevojat e konstatuara të të miturit/të miturës VMT për ndihmë dhe mbrojtje	5. Punonjësi i DRKM-së e informon punonjësën e policisë së SLKTP-së mbi të dhënat e mbledhura mbi trafikimin e personit, dhe nevojat e konstatuara të personit VMT për ndihmë dhe mbrojtje
	6. Punonjësi i DRKM-së hedh informacionin në TIMS	6. Punonjësi i DRKM-së hedh informacionin në TIMS
	7. Nëse i mituri/e mitura është i/e huaj, punonjësi i DRKM-së hedh informacionin në regjistrin kombëtar për të huajt dhe e pasqyron atë në komunikatën ditore të punës	7. Nëse personi është i/e huaj, punonjësi i DRKM-së hedh informacionin në regjistrin kombëtar për të huajt dhe e pasqyron atë në komunikatën ditore të punës
Tregues për identifikimin e viktimave të mundshme		
Tregues parësor	I mituri/e mitura informon se është keqpërdorur, abuzuar, kërcënuar, shfrytëzuar dhe është i kënaqur/e kënaqur që ka rënë në kontakt me autoritetet dhe jep shenja se kërkon ndihmë	Personi informon se është keqtrajtuar, abuzuar, kërcënuar, dhunuar, shfrytëzuar dhe jep shenja se është i/e kënaqur që ka rënë në kontakt me autoritetet dhe jep shenja se kërkon ndihmë
	I mituri/e mitura është i shoqëruar nga një i/e rritur që është i/e njohur për trafikimin e personave të rritur e të mitur	Ka informacion se personi ka qenë më parë viktimë trafikimi
	I mituri/e mitura deklaron se ka	Personi ka shenja të dukshme

	Identifikimi fillestar i të miturve në kufijtë e Republikës së Shqipërisë (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi fillestar i të rriturve në kufijtë e Republikës së Shqipërisë (të huaj dhe shqiptarë)
	punuar apo ka ndërmend të punojë në një punë të papërshtatshme për moshën e tij/saj	dhune fizike apo psikologjike
	I mituri/e mitura ka dokumente false	Personi është në shoqërinë e një personi tjetër, për të cilin ka informacion se është trafikant i qenieve njerëzore
	I mituri/e mitura që po kalon kufirin ilegalisht nuk udhëton me dijeninë e prindërve	Personi nuk ka dokumente identifikimi apo udhëtimi me vete, dokumentet e personit që udhëton ilegalisht i ka dikush tjetër që është me të, i cili nuk ka lidhje familjare apo të qëndrueshme miqësie/shoqërie me të
	I mituri/e mitura ka shenja të dukshme dhune dhe shfrytëzimi	Personi nuk ka mjete financiare për të përballuar udhëtimin në destinacion dhe ka hyrë në borxh që do ta shlyejë me punën e tij/e saj kur të mbërrijë në destinacion
	I mituri/e mitura është i/e pashoqëruar dhe mungesa e autorizimit të prindit për të udhëtuar nuk shpjegohet thjesht me neglizhencën e prindërve	
	I mituri/e mitura nuk ka pasaportë apo ndonjë dokument identifikimi dhe rezulton si i paregjistruar (nuk ka pasur ndonjëherë dokument)	
Tregues dytësorë	I mituri/e mitura është i/e frikësuar apo i/e pakënaqur që ka rënë në kontakt me autoritetet, qëndron i/e mbyllur dhe refuzon të flasë apo ka frikë të flasë me një person të ligjit	Personit të cilit i është premtuar punë, shkollë, martesë etj., nuk di të tregojë rrethanat
	I mituri/e mitura duket i/e lënë pas dore: është i/e kequshqyer, i/e veshur në mënyrë të papërshtatshme për moshën apo kushtet atmosferike	Personi është i frikësuar ose i pakënaqur që ka rënë në kontakt me autoritetet
	I mituri/e mitura paraqet vetëbesim dhe pjekuri të pazakontë për moshën e tij/saj	Personi deklaron se nuk ka kontakt me familjen
	I mituri/e mitura deklaron se e	Personi duket i/e kequshqyer: i

	Identifikimi fillestar i të miturve në kufijtë e Republikës së Shqipërisë (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi fillestar i të rriturve në kufijtë e Republikës së Shqipërisë (të huaj dhe shqiptarë)
	ka siguruar dokumentin e udhëtimit dhe vizën nga familjarët	veshur në mënyrë të papërshtatshme për kushtet atmosferike
	I mituri ka para apo sende me vete për të cilat nuk ka një shpjegim bindës	
	I mituri/e mitura është i /e shoqëruar nga një i rritur/ e rritur jo familjar i cili/e cila ngul këmbë të qëndrojë me të gjatë gjithë kohës	

7.1.2 Identifikimi dhe referimi formal pas identifikimit fillestar në kufi

	Identifikimi formal i të miturve (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve (të huaj dhe shqiptarë)
Qëllimi	Të mblidhet dhe analizohet informacion i thelluar për situatën e të miturit/të miturës, të përcaktohet nëse personi i/e mitur është viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore (VT), të vlerësohen në mënyrë të thelluar nevojat e personit të mitur për ndihmë dhe mbrojtje, të vendoset i mituri/e mitura sa më parë që është e mundur në një ambient të përshtatshëm e të mbrojtur, të jepen udhëzime të qarta dhe të sakta për rehabilitimin e personit të mitur, dhe të grumbullohet informacion i nevojshëm për ndjekjen e veprës penale të trafikimit	Të mblidhet dhe analizohet informacioni për personin e rritur, të përcaktohet nëse personi është viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore (VT), të vlerësohen në mënyrë të thelluar nevojat e personit për ndihmë dhe mbrojtje, të jepen udhëzime të qarta dhe të sakta për rehabilitimin dhe riintegrimin e personit, dhe të grumbullohet informacion i nevojshëm për ndjekjen e veprës penale të trafikimit
Treguesit e suksesit	Numri i intervistave të të miturve viktimë të mundshme të trafikimit. Numri i të miturve viktimë të mundshme (VMT) apo viktimë të trafikimit (VT) të referuar të vendosur në një ambient të mbrojtur e të përshtatshëm për nevojat e tyre	Numri i intervistave të të rriturve viktimë të mundshme të trafikimit. Numri i të rriturve viktimë të mundshme (VMT) apo viktimë të trafikimit (VT) të referuar për mbrojtje e ndihmë
Metoda e identifikimit formal	Intervista formale për të mitur	Intervista formale për të rritur
Përgjegjës i drejtpërdrejtë/kush e bën	G/SPIF: Punonjësi i policisë i SLKTP-së dhe punonjësi social i ZRSHSSH-së në rajonin ku	G/SPIF: Punonjësi i policisë i SLKTP-së dhe punonjësi social i ZRSHSSH-së në rajonin ku

	Identifikimi formal i të miturve (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve (të huaj dhe shqiptarë)
	ndodhet pika e kalimit të kufirit ku është bërë identifikimi fillestar (me ndihmën e një përkthyesi në rastin e të miturit/të miturës së huaj)	ndodhet pika e kalimit të kufirit ku është bërë identifikimi fillestar (me ndihmën e një përkthyesi në rastin të rriturit/të rriturës së huaj)
Monitorues i drejtpërdrejtë i procesit	Shefi i sektorit të luftës kundër krimit të organizuar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut dhe shefi i sektorit të luftës kundër trafikeve të paligjshme në DPPSH, drejtori i ZRSHSSH-së dhe drejtori i SHSSH-së	Shefi i sektorit të luftës kundër krimit të organizuar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut dhe shefi i sektorit të luftës kundër trafikeve të paligjshme në DPPSH, drejtori i ZRSHSSH-së dhe drejtori i SHSSH-së
Koha	Maksimumi për një intervistë formale 45 minuta (në rastin e të miturve të huaj 90 minuta duke dhënë gjysmën e kohës për përkthim)	Maksimumi për një intervistë formale 60 minuta (në rastin e të rriturve të huaj 120 minuta duke dhënë gjysmën e kohës për përkthim)
Vendi	Ambientet e intervistimit të policisë SLKTP-së së qarkut	Ambientet e intervistimit të policisë SLKTP-së së qarkut
Dokumentimi i procesit	1. Deklarata e konfidencialitetit (në rastin e të miturve të huaj, aneksi 9.1)	1. Deklarata e konfidencialitetit (në rastin e të rriturve të huaj, aneksi 9.1)
	2. Leja e informuar për intervistë (aneksi 9.2)	2. Leja e informuar për intervistë (aneksi 9.2)
	3. Format i konkludimit të intervistës formale dhe nevojave të të miturit/të miturës (aneksi 9.4), ose nëse intervista nuk është zhvilluar formati i konkludimit pa intervistë formale (aneksi 9.5) i plotësuar dhe firmosur nga punonjësi i SLKTP-së dhe punonjësi social i ZRSHSSH-së (nga 2 anëtarët e G/SPIF-së). Ky format ka një (1) origjinal i cili qëndron me punonjësin e policisë së SLKTP-së, dhe tri (3) kopje nga të cilat: 1 e mban punonjësi social i ZRSHSSH-së; 1 i jepet punonjësit të qendrës apo rezidencës ku jepet i mituri/e mitura për ndihmë dhe mbrojtje; dhe 1 i bashkëngjitet relacionit për autoritetin përgjegjës	3. Format i konkludimit të intervistës dhe nevojave të personit (aneksi 9.4), ose nëse intervista nuk është zhvilluar formati i konkludimit pa intervistë formale (aneksi 9.5) i plotësuar dhe firmosur nga punonjësi i SLKTP-së dhe punonjësi social i ZRSHSSH-së (nga 2 anëtarët e G/SPIF-së). Ky format ka një (1) origjinal i cili qëndron me punonjësin e policisë së SLKTP-së, dhe tri (3) kopje nga të cilat: 1 e mban punonjësi social i ZRSHSSH-së; 1 i jepet punonjësit të qendrës apo rezidencës ku shkon personi për ndihmë dhe mbrojtje; dhe 1 i bashkëngjitet relacionit për autoritetin përgjegjës
	4. Deklaratë për vendimin e informuar për ndihmë (aneksi 9.6) e firmosur nga i mituri/e mitura, personi apo kujdestari i	4. Deklaratë për vendimin e informuar për ndihmë (aneksi 9.6), e firmosur nga personi në 1 origjinal dhe 4 kopje: origjinali

	Identifikimi formal i të miturve (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve (të huaj dhe shqiptarë)
	tij/e saj, në 1 origjinal dhe 4 kopje: origjinali qëndron me punonjësën e policisë së SLKTP-së, 1 kopje i jepet personit vetë, 1 i jepet punonjësit social të ZRSHSSH-së, 1 i jepet institucionit ku ka vendosur të shkojë i mituri/e mitura, 1 i bashkëngjitet relacionit për AP-në	qëndron me punonjësën e policisë së SLKTP-së, 1 kopje i jepet personit vetë, 1 i jepet punonjësit social të ZRSHSSH-së, 1 i jepet institucionit ku ka vendosur të shkojë personi, 1 i bashkëngjitet relacionit për AP-në
	5. Dokumenti i marrjes në kujdes të të miturit/të miturës nga familja (aneksi 9.7) ose nga institucioni (aneksi 9.8). Në 2 origjinale dhe 2 kopje: 1 origjinal qëndron me punonjësën e SLKTP-së, 1 origjinal i jepet punonjësit të qendrës ku shkon i mituri/e mitura ose familjes në rast se i mituri/e mitura vendos të shkojë në familje, 1 kopje i jepet punonjësit social të ZRSHSSH-së dhe 1 kopje i bashkëngjitet relacionit për autoritetin përgjegjës	5. Dokumentimi i shoqërimit në rast rreziku/nëse është vlerësuar i nevojshëm dhe është bërë
	6. Dokumentimi i shoqërimit në rast rreziku/nëse është vlerësuar i nevojshëm dhe është bërë	6. Relacioni për autoritetin përgjegjës mbi intervistën formale (aneksi 9.9) ose relacionit të referimit pa intervistë formale (aneksi 9.10)
	7. Relacioni për autoritetin përgjegjës mbi intervistën formale (aneksi 9.9) ose relacionit të referimit pa intervistë formale (aneksi 9.10)	7. Çdo lloj dokumenti tjetër që është mbajtur apo hartuar për veprime për ndjekjen e çështjes sipas procedurës, duke siguruar gjithnjë që një kopje e dokumentit t'i shkojë AP-së
	8. Çdo lloj dokumenti tjetër që është mbajtur apo hartuar për veprime për ndjekjen e çështjes sipas procedurës, duke siguruar gjithnjë që një kopje e dokumentit t'i shkojë AP-së	8. Listë e azhurnuar e kontakteve dhe informacion për AP-në dhe institucionet e ndihmës
	9. Listë e azhurnuar e kontakteve dhe informacion për AP-në dhe institucionet e ndihmës	
Hapat	1. Punonjësi i policisë i SLKTP-së paraqitet menjëherë në pikën e kalimit të kufirit (PKK) me njoftimin e punonjësit të Policisë	1. Punonjësi i policisë i SLKTP-së paraqitet menjëherë në PKK me njoftimin e punonjësit të Policisë së Kufirit dhe

	Identifikimi formal i të miturve (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve (të huaj dhe shqiptarë)
	së Kufirit dhe Migracionit për identifikimin e një viktime të mundshme të trafikimit të mitur	Migracionit për identifikimin e një viktime të mundshme të trafikimit të rritur
	2. Punonjësi i policisë i SLKTP-së merr masa mbrojtëse për të miturin/të miturën duke e çuar të miturin/në ambientet e intervistimit të policisë së SLKTP-së	2. Punonjësi i policisë i SLKTP-së çon të rriturin e identifikuar si viktimë e mundshme (VM) në kufi në ambientet e intervistimit të policisë së SLKTP-së
	3. Punonjësi i policisë i SLKTP-së thërret pjesëtarin tjetër të grupit/strukturës së identifikimit formal (G/SPIF), punonjës social të zyrës rajonale të shërbimit social të vendit ku do të kryhet intervistimi	3. Punonjësi i policisë i SLKTP-së thërret pjesëtarin tjetër të grupit/strukturës përgjegjëse për identifikim formal (G/SPIF) punonjës social të zyrës rajonale të shërbimit social të vendit ku do të kryhet intervistimi
	Në rast se i mituri/e mitura është i/e huaj, punonjësi i policisë i SLKTP-së kërkon përkthyes (të njëjtin me atë të përdorur në kufi) dhe nënshkruan me të marrëveshjen e konfidencialitetit (aneksi 9.1)	Në rast se i rrituri/e rritura është i/e huaj, punonjësi i policisë i SLKTP-së kërkon përkthyes (të njëjtin me atë të përdorur në kufi) dhe nënshkruan me të marrëveshjen e konfidencialitetit (aneksi 9.1)
	4. Punonjësi i policisë i SLKTP-së njofton për paraqitje në polici prindin ose kujdestarin e të miturit/të miturës nëse prindi apo kujdestari nuk ka qenë i pranishëm deri atëherë	4. Punonjësi i Policisë i SLKTP-së dhe punonjësi social i shpjegojnë personit VMT, qëllimet e intervistës formale dhe mënyrat se si do të përdoret informacioni i dhënë gjatë intervistës formale dhe marrin leje për intervistë formale (aneksi 9.2)
	5. Punonjësi i policisë i SLKTP-së dhe punonjësi social i ZRSHSSH-së (G/SPIF) i shpjegojnë të miturit/të miturës VMT dhe prindit/kujdestarit të tij/saj qëllimin e intervistës formale, dallimin që intervista ka nga kallëzimi, dhe mënyrat se si do të përdoret informacioni i dhënë gjatë intervistës formale dhe kërkojnë leje për intervistë formale (aneksi 9.2)	5. G/SPIF bën intervistimin formal të personit me ndihmën e përkthyesit (intervista formale e të rriturve aneksi 9.11)
	Në rast se i mituri/e mitura dhe prindi apo kujdestari i tij/e saj ligjor nuk pranojnë të zhvillojnë intervistën formale, ose në rast se punonjësi i policisë i SLKTP-së	Në rast se personi nuk pranon të zhvillojë intervistën formale, ose në rast se punonjësi i policisë i SLKTP-së dhe punonjësi social (G/SPIF) gjykojnë se intervista

	Identifikimi formal i të miturve (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve (të huaj dhe shqiptarë)
	së dhe punonjësi social (G/SPIF) gjykojnë se intervista duhet të shtyhet për shkaqe të ndryshme, ata vazhdojnë ta konsiderojnë të miturin/të miturën VMT sipas përcaktimit të punonjësit të PKM-ja, dhe procedojnë me hapat 8, e më tej sipas konsultimit me AP-në dhe vendimit të të miturit/të miturës dhe prindit/kujdestarit ligjor të tij/saj	nuk mund të zhvillohet për shkaqe të ndryshme ata vazhdojnë ta konsiderojnë personin VMT siç e ka përcaktuar PKM-ja dhe procedojnë me hapat 7 e më pas sipas konsultimit me AP-në dhe vendimit të personit
	6. G/SPIF-ja bën intervistimin formal të të miturit/të miturës (me ndihmën e përkthyesit nëse i mituri/e mitura është i huaj/e huaj) dhe të prindit ose kujdestarit nëse informacioni i marrë paraprakisht nuk tregon përfshirje të prindit apo kujdestarit në trafikim apo abuzim (formati i intervistës formale i të miturve aneksi 9.3)	6. G/SPIF-ja bën analizën e intervistës duke konkluduar për statusin e personit në lidhje me trafikimin, dhe nevojat e tij/saj për siguri e kujdes (aneksi 9.4)
	7. G/SPIF-ja bën analizën e intervistës duke konkluduar për statusin e të miturit/të miturës në lidhje me trafikimin, dhe nevojat e tij/saj për siguri e kujdes (shih formati i konkludimit të intervistës, aneksi 9.4)	7. Punonjësi social informon anëtarin e AP-së nga MPCSSHB-ja për situatën e personit dhe konsultohet me të për vendosjen e personit në një ambient të përshtatshëm për nevojat e tij/saj
	8. Punonjësi social i ZRSHSSH-së (anëtari i G/SPIF) informon anëtarin e AP nga MPCSSHB për situatën e të miturit/të miturës dhe konsultohet me të për vendosjen e të miturit/të miturës në një ambient të përshtatshëm për nevojat e tij/saj	8. Punonjësi i policisë i SLKTP-së dhe punonjësi social, e informojnë personin për ndihmën që mund t'i jepet dhe e ndihmojnë të marrë vendim lidhur me ndihmën (aneksi 9.6)
		Në rast të vendimit për akomodim të përkohshëm në një institucion publik apo privat të licencuar të përkujdesjes shoqërore
	9. G/SPIF-ja informon të miturin/të miturën dhe prindin apo kujdestarin për ndihmën që mund t'i jepet dhe i ndihmon ata të marrin një vendim të informuar për ndihmën	9. G/SPIF-ja kontakton me punonjës të institucionit të përkujdesjes shoqërore të ofruar nga AP-ja për ndihmë dhe të pranuar nga personi viktimë e mundshme (VMT) apo viktimë e trafikimit (VT) dhe organizojnë

	Identifikimi formal i të miturve (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve (të huaj dhe shqiptarë)
		transportin në institucion
	10. G/SPIF-ja ndihmon të miturin/të miturën dhe prindin apo kujdestarin e tij/saj të deklarojnë me shkrim vendimin e tyre të informuar për ndihmën (aneksi 9.6)	10. G/SPIF-ja prezantojnë personin viktimë të trafikimit (VT) ose (VMT) te punonjësi i qendrës së kujdesit për viktimat e trafikimit
	Në rast të vendimit për akomodim të përkohshëm në një institucion shtetëror ose joshtetëror të licencuar të përkujdesjes shoqërore	
	11. G/SPIF-ja kontakton me punonjësin e institucionit të përkujdesit shoqëror të sugjeruar/vendosur nga AP për ndihmë dhe të pranuar nga i mituri/e mitura dhe kujdestari apo prindi dhe organizon transportin e sigurt të të miturit/të miturës në institucion	11. G/SPIF-ja dorëzon te punonjësi i qendrës së kujdesit për viktimat e trafikimit një kopje të konkluzionit/vlerësimit të nevojave të personit për kujdes dhe mbrojtje dhe bien dakord me të për komunikimin dhe hapat e mëtejshëm për ndihmën dhe mbrojtjen e tij/saj
	12. G/SPIF-ja prezanton të miturin/të miturën te punonjësi i qendrës së kujdesit për viktimat e trafikimit, ose të qendrës rezidenciale të përkujdesit shoqëror për të mitur të autorizuar e dërguar nga AP-ja	12. Punonjësi i Policisë së SLKTP-së organizon shoqërimin e personit (VMT) ose (VT) për në vendin e akomodimit në rast se vlerësohet se vetë personi dhe personat që kujdesen për të rrezikohen gjatë udhëtimit
		Në rast të refuzimit nga ana e personit për akomodim të përkohshëm në një institucion publik apo privat të licencuar të përkujdesjes shoqërore
	13. G/SPIF-ja dorëzon te punonjësi i qendrës së kujdesit për viktimat e trafikimit ose i qendrës rezidenciale të përkujdesit shoqëror për të mitur një kopje të vlerësimit të nevojave të të miturit/të miturës për kujdes dhe mbrojtje dhe bien dakord me të për komunikimin dhe hapat e mëtejshëm për ndihmën dhe mbrojtjen e tij/saj	9. G/SPIF-ja i jep personit VMT, ose VT informacion se ku duhet të drejtohet në rast rreziku në komunitetin ku do të banojë
	14. G/SPIF-ja jep të miturin/të miturën te punonjësi i qendrës ku do shkojë i mituri/e mitura (aneksi 9.8)	10. G/SPIF-ja e informon personin se për të do të informohet ZRSHSH-ja si edhe për detyrat e ZRSHSSH-së për dhënien dhe ndërmjetësimin e ndihmës për VMT-në dhe VT-në

	Identifikimi formal i të miturve (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve (të huaj dhe shqiptarë)
		në vendin ku banojnë
	15. Punonjësi i Policisë së SLKTP-së (anëtari G/SPIF) organizon shoqërimin e të miturit/të miturës për në vendin e akomodimit në rast se vlerësohet se i mituri/e mitura dhe personat që kujdesen për të rrezikohen gjatë udhëtimit	11. Me largimin e personit, G/SPIF-ja harton një relacion të procesit të kryer dhe e dërgon tek autoriteti përgjegjës (aneksi 9.9). Në rast se personi nuk ka pranuar të zhvillojë intervistën formale apo nuk ka pasur kushte për intervistë formale për relacionin tek AP-ja përdoret aneksi 9.10)
	16. Me largimin e personit të mitur, G/SPIF-ja harton një relacion të procesit të kryer dhe e dërgon tek autoriteti përgjegjës (aneksi 9.9) (në rast se i mituri/e mitura apo kujdestari nuk ka pranuar të zhvillojë intervistën formale apo nuk ka pasur kushte për intervistë formale G/SPIF-ja përdor aneksin 9.10 për relacionin tek AP-ja)	12. Punonjësi i policisë i SLKTP-së bën veprimet e nevojshme për fillimin e çështjes penale ndaj trafikantit/trafikantëve
	18. Punonjësi i policisë i SLKTP-së nis veprimet për ndjekjen e çështjes sipas procedurës	
	Në rast të vendimit për kthim në familje	
	11. G/SPIF-ja japin të miturin/të miturën te familja (aneksi 9.7)	
	12. G/SPIF-ja i jep të miturit/të miturës dhe familjarëve informacion se ku duhet të drejtohen për ndihmë në rast rreziku imediat në komunitetin ku banojnë	
	13. G/SPIF-ja informojnë të miturin/të miturën se për situatën e të miturit/të miturës do të njoftohet ZRSHSSH-ja në komunitetin ku banojnë dhe Komitetin Rajonal për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (KRAT) i Qarkut ku ndodhet familja e personit të kthyer me qëllim sigurimin e një përkujdesjeje të mëtejshme	
	14. Punonjësi i policisë i SLKTP-së dhe punonjësi social informojnë të miturin/të miturën	

	Identifikimi formal i të miturve (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve (të huaj dhe shqiptarë)
	dhe familjen për detyrat e ZRSHSSH-së dhe Komitetit Rajonal për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore për dhënien dhe ndërmjetësimin e ndihmës për VMT-në dhe VT-në në vendin ku banojnë	
	15. Me mbylljen e intervistës dhe largimin e personit të mitur, G/SPIF-ja harton një relacion të procesit të kryer dhe e dërgon tek autoriteti përgjegjës (aneksi 9.9);	
	16. Punonjësi i policisë i SLKTP-së bën veprimet e nevojshme për fillimin e çështjes penale ndaj trafikantit/trafikantëve	

7.2 Identifikimi dhe referimi në territor

7.2.1 Identifikimi dhe referimi fillestar në territor

	Identifikimi fillestar i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi fillestar i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
Qëllimi	Të identifikohen viktimat e mundshme të trafikimit (VMT) të mitur, nëpërmjet vlerësimit të situatës/elementeve të sjelljes dhe gjendjes së tij/saj fizike, mendore, sociale dhe ekonomike kundrejt listës së treguesve, t'u jepet atyre informacion për të drejtat dhe ndihmën në dispozicion të viktimave të trafikimit dhe mënyrat e qasjes të ndihmës, të jepet ndihmë e parë për t'i nxjerrë të miturit nga rrjeti i shfrytëzimit dhe për rehabilitimin e tij/saj sa më të shpejtë në një mjedis të sigurt, të njoftohet AP-ja dhe struktura përgjegjëse për identifikim formal në rast se i mituri/e mitura dhe kujdestari i tij/e saj ligjor dëshiron të identifikohet formalisht	Të identifikohen viktimat e mundshme të trafikimit (VMT) të rritur, nëpërmjet vlerësimit të situatës së personit/elementeve të sjelljes dhe gjendjes së tij fizike, mendore, sociale dhe ekonomike kundrejt listës së treguesve, t'u jepet atyre informacion për të drejtat dhe ndihmën në dispozicion të viktimave të trafikimit dhe mënyrat e qasjes të ndihmës, t'u jepet viktimave të mundshme akses dhe ndihmë e parë për ta nxjerrë personin nga rrjeti i shfrytëzimit dhe për rehabilitimin e tij/saj sa më të shpejtë në një mjedis të sigurt, të njoftohet AP dhe struktura përgjegjëse për identifikim formal nëse personi dëshiron të identifikohet formalisht
Treguesit e suksesit	Numri i të miturve të identifikuar dhe ndihmuar si	Numri i personave të rritur të identifikuar dhe ndihmuar si

	Identifikimi fillestar i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi fillestar i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
	viktima të mundshme të trafikimit	viktima të mundshme të trafikimit
	Numri i të miturve viktima të mundshme të trafikimit të referuar për intervistë formale	Numri i personave të rritur viktima të mundshme të trafikimit të referuar për intervistë formale
Metoda e identifikimit	Intervistë për qëllime të ndihmës, observim, vlerësim i informacionit nga individë të veçantë apo agjenci të tjera shtetërore dhe joshtetërore kundrejt treguesve të trafikimit	Intervistë për qëllime të ndihmës, observim, vlerësim i informacionit nga individë të veçantë apo agjenci të tjera shtetërore dhe joshtetërore kundrejt treguesve të trafikimit
Përgjegjës i drejtpërdrejtë/kush e bën	Punonjësit e agjencive/ institucioneve shtetërore dhe joshtetërore të strehëzave për viktimat e trafikimit, të qendrave të përkujdesjes shoqërore për persona në nevojë, të organizatave me programe të ndihmës për persona në nevojë, të zyrave të shërbimit social në rajone, të strukturave të policisë së shtetit, të inspektoratit të punës, të zyrave të punës, të drejtorive rajonale të arsimit, të drejtorive rajonale të shëndetit, të njëjësive për mbrojtjen e fëmijëve (punonjësi i A/IPIF-së)	Punonjësit e agjencive/ institucioneve shtetërore dhe joshtetërore të strehëzave për viktimat e trafikimit, të qendrave të përkujdesjes shoqërore për persona në nevojë, të organizatave me programe të ndihmës për persona në nevojë, të zyrave të shërbimit social në rajone, të strukturave të policisë së shtetit, të inspektoratit të punës, të zyrave të punës, të drejtorive rajonale të arsimit, të drejtorive rajonale të shëndetit (punonjësi i A/IPIF-së)
Monitorues i drejtpërdrejtë i procesit	Eprori i drejtpërdrejtë i punonjësit të agjencisë/institucionit shtetëror ose joshtetëror përgjegjës për identifikimin fillestar në territor dhe drejtuesi i A/IPIF-së	Eprori i drejtpërdrejtë i punonjësit të agjencisë/institucionit shtetëror ose joshtetëror përgjegjës për identifikimin fillestar në territor dhe drejtuesi i A/IPIF-së
Koha	E pakufizuar por sa më shpejt që është e mundur pas rënies në kontakt me të miturin viktimë e mundshme (VM) apo marrjes së informacionit se një i mitur/e mitur mund të jetë viktimë e trafikimit	E pakufizuar por sa më shpejt që është e mundur pas rënies në kontakt me viktimën e mundshme (VM) apo marrjes së informacionit se një person mund të jetë viktimë e trafikimit
Vendi i identifikimit	Kudo ku veprojnë agjencitë/ institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar (A/IPIF-ja)	Kudo ku veprojnë agjencitë/ institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar (A/IPIF-ja)
Dokumentimi i procesit	1. Deklaratë e konfidencialitetit (nëse i mituri/e mitura është i/e huaj, aneksi 9.1)	1. Deklaratë e konfidencialitetit (nëse i rrituri/e rritura është i/e huaj, aneksi 9.1)
	2. Dokumenti i dhënies së	2. Dokumenti i dhënies së

	Identifikimi fillestar i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi fillestar i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
	ndihmës (deklarata e ofrimit dhe pranimit të ndihmës në gjuhën e të miturit/të miturës, formatet e institucionit/formatet e A/IPIF-së)	ndihmës (deklarata e ofrimit dhe pranimit të ndihmës formatet e institucionit/formatet e A/IPIF-së)
	3. Njoftimi me shkrim i autoritetit përgjegjës në 1 origjinal i cili i dërgohet AP-së, dhe 2 kopje: 1 kopje mbahet nga A/IPIF-ja që ka bërë njoftimin; 1 i bashkëngjitet kërkesës për intervistë formale nëse i/e mitura dëshiron të intervistohet nga grupi përgjegjës për identifikim formal (aneksi 9.12)	3. Njoftimi me shkrim i autoritetit përgjegjës në 1 origjinal i cili i dërgohet AP, dhe 2 kopje: 1 kopje mbahet nga A/IPIF-ja që ka bërë njoftimin; 1 i bashkëngjitet kërkesës për intervistë formale nëse personi dëshiron të intervistohet nga grupi përgjegjës për identifikim formal (aneksi 9.12)
	4. Kërkesa për ndërhyrje të menjëhershme te punonjësi i SLKTP-së i qarkut ku ndodhet aktualisht i mituri/e mitura viktimë e mundshme në një (1) origjinal dhe dy (2) kopje: 1 origjinal i dërgohet Policisë së SLKTP-së, një kopje i dërgohet për dijeni AP-së dhe një kopje mbahet nga agjencia/institucioni përgjegjës për identifikim fillestar në territor (aneksi 9.13)	4. Kërkesa për ndërhyrje të menjëhershme te punonjësi i SLKTP i qarkut ku ndodhet aktualisht viktimja e mundshme në një (1) origjinal dhe dy (2) kopje: 1 origjinal i dërgohet Policisë së SLKTP-së, një kopje i dërgohet për dijeni AP-së dhe një kopje mbahet nga agjencia/institucioni përgjegjës për identifikim fillestar në territor (aneksi 9.13)
	5. Çdo lloj dokumenti tjetër që vërteton se agjencia/institucioni përgjegjës për identifikim fillestar (A/IPIF) ka bërë përpjekje për vlerësim të situatës dhe ndërhyrje për ta shpëtuar të miturin/të miturën kur ka ekzistuar dyshimi se i mituri/e mitura po abuzohet, shfrytëzohet apo trafikohet (është VMT)	5. Çdo lloj dokumenti tjetër që vërteton se agjencia/institucioni përgjegjës për identifikim fillestar (A/IPIF) ka bërë përpjekje për vlerësim të situatës dhe ndërhyrje për ta shpëtuar personin, kur ka ekzistuar dyshimi se personi po abuzohet, shfrytëzohet apo trafikohet (është VMT)
	6. Kërkesë te SLKTP-ja më e afërt për identifikim formal nëse i mituri/e mitura (kujdestari i tij/e saj ligjor i papërfshirë në trafikim) dëshiron të identifikohet formalisht (aneksi 9.15)	6. Kërkesë te SLKTP-ja më e afërt për identifikim formal nëse personi dëshiron të identifikohet formalisht (aneksi 9.15)
	7. Njoftimi tek autoriteti përgjegjës për largimin e	7. Njoftimi tek autoriteti përgjegjës për largimin e

	Identifikimi fillestar i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi fillestar i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
	përfituesit viktimë e mundshme (VMT) apo viktimë trafikimi (VT) nga programi i ndihmës (aneksi 9.14)	përfituesit viktimë e mundshme (VMT) apo viktimë trafikimi (VT) nga programi i ndihmës (aneksi 9.14)
Hapat	1. Punonjësi i agjencisë/institucionit të lartpërmendur si përgjegjës i drejtpërdrejtë për identifikimin fillestar në territor (A/IPIF) vlerëson se i mituri/e mitura është viktimë e mundshme e trafikimit (VMT) (përdor listën e treguesve më poshtë)	1. Punonjësi i agjencisë/institucionit të lartpërmendur si përgjegjës i drejtpërdrejtë për identifikimin fillestar në territor (A/IPIF) vlerëson se personi është viktimë e mundshme e trafikimit (VMT) (përdor listën e treguesve më poshtë)
	Nëse punonjësi dhe eprori i tij/e saj gjykojnë se nuk kanë mundësi të bëjnë një vlerësim të përshtatshëm dhe të ndërhyjnë në mënyrë të menjëhershme dhe të sigurt për ndalimin e trafikimit të të miturit dhe rehabilitimin e tij/e saj agjencia/institucioni (A/IPIF) njofton në mënyrë të menjëhershme punonjësit e policisë të SLKTP më të afërt, dhe i kërkojnë të ndërhyjë për verifikimin e situatës së të miturit/të miturës dhe marrjen e masave mbrojtëse për të miturin/të miturën (aneksi 9.13)	Nëse punonjësi dhe eprori i tij/e saj gjykojnë se nuk kanë mundësi të bëjnë një vlerësim të përshtatshëm dhe të ndërhyjnë në mënyrë të menjëhershme dhe të sigurt për ndalimin e trafikimit të personit agjencia/institucioni (A/IPIF) njofton në mënyrë të menjëhershme punonjësit e policisë të SLKTP më të afërt, duke i kërkuar të ndërhyjë për verifikimin e situatës dhe mbrojtjen e personit (aneksi 9.13)
	2. Punonjësi i A/IPIF bën një vlerësim të nevojave të të miturit/të miturës me pjesëmarrjen e tij/saj dhe të prindit apo kujdestarit të tij/saj (nëse gjykon se prindi apo kujdestari nuk është përfshirë në trafikim) dhe këshillohet me eprorin e tij/e saj për të marrë masa të menjëhershme që në gjykimin e tyre janë të nevojshme dhe të mundshme për ndalimin e shfrytëzimit të të miturit dhe rehabilitimin e sigurt të tij/të saj (marrëveshja e konfidencialitetit, aneksi 9.1 për komunikimin me personin e mitur të huaj)	2. Punonjësi i A/IPIF e informon personin viktimë e mundshme e trafikimit për mundësitë e ndihmës për viktimat e trafikimit përfshirë mundësitë që jep identifikimi formal
	3. Punonjësi i A/IPIF-së e	3. Nëse personi pranon,

	Identifikimi fillestar i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi fillestar i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
	informon të miturin/të miturën dhe prindin apo kujdestarin e tij/saj ligjor nëse gjykon se prindi apo kujdestari nuk është përfshirë në trafikim për mundësitë e ndihmës për viktimat e trafikimit përfshirë mundësitë që jep identifikimi formal	punonjësi i A/IPIF-së bën një vlerësim të nevojave të personit me pjesëmarrjen e tij/e saj dhe të kujdestarit të tij/të saj nëse personi i rritur ka një kujdestar (marrëveshja e konfidencialitetit, aneksi 9.1 për komunikimin me personin e rritur të huaj)
	4. Punonjësi i A/IPIF ofron dhe aplikon ndihmë dhe mbrojtje të mundshme, të përshtatshme, dhe të pranuar vullnetarisht nga i mituri/e mitura viktimë e mundshme e trafikimit dhe kujdestari i tij/e saj ligjor	4. Punonjësi i A/IPIF njofton menjëherë gojarisht dhe brenda dy ditësh nga njoftimi gojor, me shkrim, AP-në për hapat e ndërmarra në mbrojtje të personit dhe konsultohet me të për hapat e mëtejshëm të ndërhyrjes në mbrojtje të personit
	5. Punonjësi i A/IPIF njofton menjëherë gojarisht dhe brenda dy ditësh nga njoftimi gojor, A/IPIF-ja e tij/e saj njofton me shkrim, AP-në për hapat e ndërmarra në mbrojtje të të miturit/të miturës dhe konsultohet me të për hapat e mëtejshëm të ndërhyrjes në mbrojtje të të miturit/të miturës (aneksi 9.12)	5. Punonjësi i A/IPIF-së ofron dhe aplikon ndihmë dhe mbrojtje të mundshme, të përshtatshme, dhe të pranuar vullnetarisht nga personi viktimë e mundshme e trafikimit dhe kujdestari i tij/e saj ligjor nëse ka
	6. Punonjësi i A/IPIF-së nën drejtimin e titullarit bashkëpunon me agjenci të tjera për plotësimin e nevojave të të miturit/të miturës sipas udhëzimeve të AP-së	6. Punonjësi i A/IPIF-së nën drejtimin e titullarit të A/IPIF-së bashkëpunon me agjenci të tjera për plotësimin e nevojave të personit sipas udhëzimeve të AP-së
	7. Nëse i mituri/e mitura dhe kujdestari i tij/i saj dëshirojnë të identifikohen formalisht, A/IPIF-ja, paraqet kërkesën për identifikim formal te SLKTP-ja për organizimin e intervistimit/identifikimit formal në kohën më të përshtatshme të vendosur nga i mituri/e mitura dhe kujdestari i tij/i saj ligjor, por gjithnjë brenda një afati 15 ditor nga dita e njoftimit gojor të AP-së/pranimin të të miturit në	7. Nëse personi dëshiron të intervistohet formalisht, A/IPIF-ja, paraqet kërkesën për identifikim formal te SLKTP-ja për organizimin e intervistimit/identifikimit formal në kohën më të përshtatshme të vendosur nga personi, por gjithnjë duke synuar të kryhet brenda një afati 15-ditor nga dita e njoftimit gojor të AP-së/pranimin të personit në programin e agjencisë/institucionit (aneksi 9.15)

	Identifikimi fillestar i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi fillestar i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
	programin e agjencisë/ institucionit (aneksi 9.15)	
	8. Nëse i mituri/e mitura viktimë e mundshme/viktimë trafikimi largohet nga programi i ndihmës i A/IPIF-së, ose A/IPIF-ja informohet se i mituri/e mitura është larguar nga programet e ndihmës në të cilat A/IPIF-ja e ka referuar për ndihmë A/IPIF-ja, lajmëron menjëherë AP-në (aneksi 9.14)	8. Nëse personi viktimë e mundshme/viktimë trafikimi largohet nga programi i ndihmës i A/IPIF-së, ose A/IPIF-ja informohet se personi është larguar nga programet e ndihmës, në të cilat A/IPIF-ja e ka referuar për ndihmë, A/IPIF-ja, lajmëron menjëherë AP-në (aneksi 9.14)
Tregues për identifikimin e viktimave të mundshme		
Tregues parësorë	I mituri/e mitura deklaron se është keqpërdorur, abuzuar, kërcënuar, shfrytëzuar dhe është i kënaqur/e kënaqur që ka rënë në kontakt me persona/ autoritete që japin ndihmë dhe jep shenja se kërkon ndihmë	Personi deklaron se është shfrytëzuar dhe kërkon ndihmë
	I mituri/e mitura ka shenja në trup (mavijosje p.sh.), që tregojnë dhunë fizike ose seksuale ndaj tij/saj	Personi ka ardhur në një situatë shfrytëzimi nëpërmjet rrëmbimit apo nëpërmjet një premtimi që ka rezultuar i rremë
	I mituri që lyp ka gjithmonë një të rritur pranë që e kontrollon	Personi është i detyruar të qëndrojë në një situatë shfrytëzimi për shkak të kërcënimeve dhe dhunës ndaj tij/saj ose personave të afërt me të.
	I mituri/e mitura shet ose punon	Personi nuk ka kontroll mbi jetën e tij: lëvizja, strehimi, përdorimi i të ardhurave, udhëhiqen dhe kontrollohen nga persona të tjerë
	I mituri/e mitura nuk ka kontakte me familjen dhe nuk ka person me lidhje gjaku që kujdeset për të	Transporti i personit, strehimi, punësimi, janë rregulluar nga persona që njihen apo për të cilët ka informacion se janë trafikantë apo shfrytëzues
	I mituri/e mitura është sjellë në vendin e konstatimit/qytetin apo krahinën nga një person i rritur apo më i rritur, me të cilin nuk ka lidhje familjare	
	I mituri/e mitura i paregjistruar, qëndron me persona të rritur, me të cilët	

	Identifikimi fillestar i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi fillestar i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
	nuk ka lidhje familjare	
	I mituri/e mitura është në shoqërinë e personave që shfrytëzojnë apo trafikojnë të miturit	
	I mituri/e mitura nuk ka një vendbanim të qëndrueshëm	
	I mituri/e mitura fle në rrugë	
Tregues dytësorë	I mituri/e mitura frekuenton vende të njohura për aktivitete të paligjshme (shpërndarje droge, ushtrim prostitucioni, shkëmbim mallrash të vjedhura etj.)	Kushtet në të cilat ka punuar/punon personi, kanë qenë të dëmshme për shëndetin dhe jetën e personit
	I mituri/e mitura është kapur duke vjedhur	Personit ia ka rregulluar punën, shkollën një person i cili/e cila ka marrëdhënie biznesi me punëdhënësin/punëdhënësen
	I mituri/e mitura që lyp duket i/e lënë pas dore: është i/e kequshqyer; veshur në mënyrë të papërshtatshme për moshën apo kushtet atmosferike	Personit nuk i është lejuar të zgjedhë strehimin
	E mitura ka shtatzëni të padëshiruar	Personi paguan te punëdhënësi një shumë të madhe e të pajustificueshme për strehimin e tij/saj
	I mituri/e mitura vuan nga sëmundje seksualisht të transmetueshme	Personi fshihet nga autoritetet për shkak të statusit të parregullt të punës së tij/saj
	Ka të dhëna apo informacion që i mituri/e mitura është parë në vende që njihen se përdoren për shfrytëzim seksual të fëmijëve, për lypje, punë të detyruar, apo vende të tjera të papërshtatshme për moshën	Personi nuk ka akses në kujdesin shëndetësor
	I mituri/e mitura ka lënë shtëpinë/vendin e kujdesit me rroba që janë të pazakonshme për këtë të mitur (të papërshtatshme për moshën, i ka marrë borxh prej më të rriturve)	Personi ka pasur kontakte sociale të kufizuara
	Ka të dhëna që i mituri/e mitura merr telefonata apo letra nga të rritur jashtë rrethit të zakonshëm apo kontakteve të zakonshme shoqërore	Personi nuk ka pasur kontroll mbi privatësinë dhe pronën e vet

	Identifikimi fillestar i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi fillestar i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
	Ka të dhëna që rreth rezidencës apo vendbanimit të të miturit/të miturës sillen rrotull të rritur me sjellje dhe veprimtari të dyshimtë	Personi nuk ka pasur akses në informacionin shëndetësor apo në kujdesin shëndetësor
	I mituri/e mitura qëndron jashtë banesës, i/e vetëm në orët e vona të natës	Personit nuk i respektohej e drejta e tij/e saj për kohë të lirë, pushime të paguara etj
	I mituri/e mitura ka të dashur shumë më të madh/e në moshë	Kushtet e banimit të personit nuk plotësonin nevojat e tij/e saj bazë higjieno-sanitare
	I mituri/e mitura ka shuma të mëdha parash të pajustificueshme	Personi nuk di gjuhën, dhe nuk orientohet dot në vendin ku është
	I mituri/e mitura ka munguar/ është larguar për një kohë të gjatë por nuk ka asnjë informacion mbi atë që ka ndodhur	
	I mituri/e mitura në situatë rruge ka shenja të dukshme neglizhimi dhe braktisjeje	
	I mituri/e mitura është kthyer pas një mungese, me një pamje të ndryshuar por që nuk ka ndodhur nga kujdestari ligjor apo nga prindërit	

7.2.2 Identifikimi dhe referimi formal pas identifikimit fillestar në territor

	Identifikimi formal i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
Qëllimi	Të mblidhet dhe analizohet informacion i thelluar për situatën e të miturit/të miturës së trafikuar, të përcaktohet nëse personi i mitur është viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore (VT), të vlerësohen në mënyrë të thelluar nevojat e personit të mitur për ndihmë dhe mbrojtje, të vendoset i mituri/e mitura në një ambient të përshtatshëm e të mbrojtur, të jepen udhëzime të qarta dhe të sakta për rehabilitimin e personit të mitur, dhe të grumbullohet informacion i nevojshëm për ndjekjen e	Të mblidhet dhe analizohet informacioni për situatën e personit të trafikuar, të përcaktohet nëse personi është viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore (VT), të vlerësohen në mënyrë të thelluar nevojat e personit për ndihmë dhe mbrojtje, të ndihmohet personi i trafikuar të marrë shërbimet e nevojshme dhe të përshtatshme për nevojat e tij/saj, të jepen udhëzime të qarta dhe të sakta për rehabilitimin e personit të trafikuar, dhe të grumbullohet informacion i nevojshëm për

	Identifikimi formal i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
	veprës penale të trafikimit	ndjekjen e veprës penale të trafikimit
Treguesit e suksesit	Numri i intervistave të të miturve që njoftohen te SLKTP-ja si viktimë të mundshme të trafikimit. Numri i të miturve viktimë të trafikimit të intervistuar të mbrojtur e ndihmuar	Numri i intervistave të të rriturve njoftohen te SLKTP-ja si viktimë të mundshme të trafikimit. Numri i të rriturve viktimë të trafikimit të intervistuar të mbrojtur e ndihmuar
Metoda e identifikimit	Intervista formale për të mitur	Intervista formale për të rritur
Përgjegjës i drejtpërdrejtë/kush e bën	G/SPIF: Punonjësi i policisë i SLKTP-së dhe punonjësi social i ZRSHSSH-së në qarkun/rajonin ku ndodhet i mituri/e mitura viktimë e mundshme e trafikimit (me ndihmën e një përkthyesi në rast se i mituri/e mitura është i/e huaj) dhe një punonjësi të programit (mundësisht menaxherit të rastit) ku po ndihmohet i mituri nëse ka të tillë dhe i mituri/e mitura dëshiron	G/SPIF: Punonjësi i policisë i SLKTP dhe punonjësi social i ZRSHSSH në rajonin ku ndodhet viktimë e mundshme, me ndihmën e një përkthyesi dhe një punonjësi të programit (mundësisht menaxherit të rastit) ku po ndihmohet personi nëse ka të tillë dhe personi dëshiron
Monitorues i drejtpërdrejtë i procesit	Shefi i sektorit të luftës kundër krimit të organizuar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut dhe shefi i sektorit kundër trafikeve të paligjshme në DPPSH, Drejtori i ZRSHSSH-së dhe Drejtori i SHSSH-së	Shefi i sektorit të luftës kundër krimit të organizuar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut, shefi i sektorit kundër trafikeve të paligjshme në DPPSH, Drejtori i Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtori i SHSSH-së
Koha	Maksimumi për një intervistë formale 45 minuta (në rastin e të miturve të huaj 90 minuta duke dhënë gjysmën e kohës për përkthim)	Maksimumi për një intervistë formale 60 minuta (në rastin e të rriturve të huaj 120 minuta duke dhënë gjysmën e kohës për përkthim)
Vendi	Ambientet e intervistimit të policisë SLKTP-së	Ambientet e intervistimit të policisë SLKTP-së
Dokumentimi i procesit	1. Kërkesa e A/IPIF për ndërhyrje të menjëhershme të SLKTP nëse ka (aneksi 9.13)	1. Kërkesa e A/IPIF për ndërhyrje të menjëhershme të SLKTP nëse ka (aneksi 9.13)
	2. Kërkesa e A/IPIF për identifikim formal te SLKTP nëse ka (aneksi 9.15)	2. Kërkesa e A/IPIF për identifikim formal te SLKTP nëse ka (aneksi 9.15)
	3. Deklarata e konfidencialitetit nëse i mituri/e mitura është i/e huaj (aneksi 9.1)	3. Deklarata e konfidencialitetit nëse i rrituri/e rritura është i huaj/e huaj (aneksi 9.1)
	4. Leja e informuar për intervistë (aneksi 9.2)	4. Leja e informuar për intervistë (aneksi 9.2)

	Identifikimi formal i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
	<p>5. Format i konkludimit të intervistës formale dhe nevojave të të miturit/të miturës (aneksi 9.4), ose nëse intervista nuk është zhvilluar, formati i konkludimit pa intervistë formale (aneksi 9.5) i plotësuar dhe firmosur nga anëtarët e G/SPIF-së: punonjësi i SLKTP-së dhe punonjësi social i ZRSHSSH-së. Ky format ka një (1) origjinal i cili qëndron me punonjësin e policisë së SLKTP-së, dhe tri (3) kopje nga të cilat: 1 e mban punonjësi social i ZRSHSSH-së; 1 i jepet punonjësit të qendrës apo rezidencës ku është ose jepet i mituri/e mitura për ndihmë dhe mbrojtje; dhe 1 i bashkëngjitet relacionit për AP-në</p>	<p>5. Format i konkludimit të intervistës formale (aneksi 9.4), ose nëse intervista nuk është zhvilluar formati i konkludimit pa intervistë formale (aneksi 9.5) i plotësuar dhe firmosur nga anëtarët e G/SPIF-së: punonjësi i SLKTP-së dhe punonjësi social i ZRSHSSH-së. Ky format ka një (1) origjinal i cili qëndron me punonjësin e policisë së SLKTP-së, dhe tri (3) kopje nga të cilat: 1 e mban punonjësi social i ZRSHSSH-së; 1 i jepet punonjësit të qendrës apo rezidencës ku vendos personi të shkojë për ndihmë dhe mbrojtje; dhe 1 i bashkëngjitet relacionit për AP-në</p>
	<p>6. Deklaratë për vendimin e informuar për ndihmë (aneksi 9.6) e firmosur nga i mituri/e mitura, personi apo kujdestari i tij/e saj, në 1 origjinal dhe 4 kopje: origjinali qëndron me punonjësin e policisë së SLKTP-së, 1 kopje i jepet personit vetë (prindit ose kujdestarit), 1 kopje i jepet punonjësit social të ZRSHSSH-së, 1 kopje i jepet institucionit ku ka vendosur të shkojë i mituri/e mitura pas intervistës formale, 1 i bashkëngjitet relacionit për AP-në</p>	<p>6. Deklaratë për vendimin e informuar për ndihmë (aneksi 9.6) e firmosur nga personi në 1 origjinal dhe 4 kopje: origjinali qëndron me punonjësin e policisë së SLKTP-së; 1 kopje i jepet personit vetë; 1 i jepet punonjësit social të ZRSHSSH-së; 1 kopje i jepet institucionit ku ka vendosur të shkojë personi pas intervistës formale; 1 kopje i bashkëngjitet relacionit për AP-në</p>
	<p>7. Dokumenti i marrjes në kujdes të të miturit/të miturës nga familja (aneksi 9.7) ose nga një institucion (aneksi 9.8) . Në dy (2) origjinale dhe dy (2) kopje: 1 origjinal qëndron me punonjësin e SLKTP-së; 1 origjinal i jepet punonjësit të qendrës ku shkon i mituri/e mitura ose familjes në rast se i mituri/e mitura vendos të shkojë në familje; 1 kopje i jepet punonjësit social të ZRSHSSH-</p>	<p>7. Dokumentimi i shoqërimit në udhëtim për dhe nga intervista formale nëse është vlerësuar i nevojshëm dhe është bërë</p>

	Identifikimi formal i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
	së; dhe 1 kopje i bashkëngjitet relacionit për autoritetin përgjegjës	
	8. Dokumentimi i shoqërimit në udhëtim për dhe nga intervista formale nëse është vlerësuar i nevojshëm dhe është bërë	8. Relacioni për autoritetin përgjegjës mbi intervistën formale (aneksi 9.9) ose relacioni i referimit pa intervistë formale (aneksi 9.10)
	9. Relacioni për autoritetin përgjegjës mbi intervistën formale (aneksi 9.9) ose relacioni i referimit pa intervistë formale (aneksi 9.10)	9. Çdo lloj dokumenti tjetër që është mbajtur apo hartuar për veprime për ndjekjen e çështjes sipas procedurës, duke siguruar gjithnjë që një kopje e dokumentit t'i shkojë AP-së
	10. Çdo lloj dokumenti tjetër që është mbajtur apo hartuar për veprime për ndjekjen e çështjes sipas procedurës, duke siguruar gjithnjë që një kopje e dokumentit t'i shkojë AP-së	
Hapat	1. Me marrjen e kërkesës për identifikim formal nga agjencia/ institucioni që ka identifikuar të miturin/të miturën si viktimë të mundshme të trafikimit, punonjësi i policisë i SLKTP-së krijon kushtet për intervistimin/identifikimin formal në kohën më të përshtatshme të vendosur nga i mituri/e mitura dhe prindi/ kujdestari i tij/e saj ligjor dhe ia komunikon këtë strukturës që ka kërkuar identifikimin formal dhe pjesëtarit tjetër të grupit/ strukturës përgjegjëse për identifikim formal (G/SPIF), punonjësit social të zyrës rajonale të shërbimit social shtetëror (ZRSHTSSH) të vendit ku do të kryhet intervistimi/ rajonit ku ndodhet aktualisht viktima e mundshme	1. Me marrjen e kërkesës për identifikim formal nga agjencia/ institucioni që ka identifikuar personin si viktimë të mundshme të trafikimit, punonjësi i policisë i SLKTP-së krijon kushtet për intervistimin/identifikimin formal në kohën më të përshtatshme të vendosur nga personi dhe ia komunikon këtë strukturës që ka kërkuar identifikimin formal dhe pjesëtarit tjetër të grupit/strukturës përgjegjëse për identifikim formal (G/SPIF), punonjësit social të zyrës rajonale të shërbimit social shtetëror (ZRSHTSSH) të vendit ku do të kryhet intervistimi/ rajonit ku ndodhet aktualisht viktima e mundshme
	2. Punonjësi i policisë i SLKTP-së njofton për paraqitje në polici prindin ose kujdestarin e të miturit/të miturës	2. Punonjësi i policisë i SLKTP-së organizon transportin e viktimës së mundshme të trafikimit (VMT) dhe menaxherit të rastit nëse ka, në ambientet e SLKTP-së

	Identifikimi formal i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
	Në rast se i mituri/e mitura është i/e huaj, punonjësi i policisë i SLKTP-së kërkon përkthyes dhe nënshkruan me të marrëveshjen e konfidencialitetit (aneksi 9.1)	Në rast se i rrituri/e rritura është i/e huaj, punonjësi i policisë i SLKTP-së kërkon përkthyes dhe nënshkruan me të marrëveshjen e konfidencialitetit (aneksi 9.1);
	3. Punonjësi i policisë i SLKTP-së organizon transportin e të miturit /të miturës viktimë e mundshme e trafikimit dhe menaxherit të rastit nëse ka, në ambientet e SLKTP-së	3. G/SPIF: Punonjësi i policisë i SLKTP-së dhe punonjësi social i ZRSHSSH-së kërkojnë informacion nga menaxheri i rastit (nëse ka të pranishëm) për vlerësimin e situatës së personit ndihmën dhe mbrojtjen që po merr aktualisht, dhe çdo lloj shqetësimi apo këshillë paraprake që menaxheri i rastit ka për të dhënë lidhur me intervistimin formal për të mënjeluar marrjen e përsëritur e të panevojshme të informacionit
	4. G/SPIF: Punonjësi i policisë i SLKTP-së dhe punonjësi social i ZRSHSSH-së kërkojnë informacion nga menaxheri i rastit (nëse ka të pranishëm) për vlerësimin e situatës së të miturit/të miturës, ndihmën dhe mbrojtjen që po merr aktualisht, dhe çdo lloj shqetësimi apo këshillë paraprake që menaxheri i rastit ka për të dhënë lidhur me intervistimin formal të të miturit/të miturës, për të mënjeluar marrjen e përsëritur e të panevojshme të informacionit	4. G/SPIF-ja i shpjegon personit qëllimin e intervistës formale, dallimin që intervista ka nga kallëzimi, dhe mënyrat se si do të përdoret informacioni i dhënë gjatë intervistës formale dhe marrin leje për intervistë (aneksi 9.2)
	Në rast se nuk ka kushte për intervistë formale, ose i mituri/e mitura dhe kujdestari i tij/e saj ligjor nuk dëshiron të intervistohet, G/SPIF-ja vijon me hapat 8 e më pas	Në rast se nuk ka kushte për intervistë formale, ose personi nuk dëshiron të intervistohet, G/SPIF vijon me hapat 7 e më pas
	5. G/SPIF-ja i shpjegon të miturit dhe prindit/kujdestarit të tij/të saj (nëse informacioni i marrë paraprakisht nuk tregon përfshirje të prindit apo kujdestarit në trafikim apo abuzim) qëllimin e intervistës formale, dallimin që intervista ka nga kallëzimi, dhe mënyrat se si	5. Punonjësi i policisë i SLKTP-së dhe punonjësi social bëjnë intervistimin formal të personit me ndihmën e përkthyesit në prani të menaxherit të rastit nëse ka (aneksi 9.3)

	Identifikimi formal i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
	do të përdoret informacioni i dhënë gjatë intervistës formale dhe marrin leje për intervistë (aneksi 9.2)	
	6. Punonjësi i policisë i SLKTP-së dhe punonjësi social (G/SPIF) bëjnë intervistimin formal të të miturit/të miturës (me ndihmën e përkthyesit nëse i/e huaj) në prani të prindit ose kujdestarit nëse informacioni i marrë paraprakisht nuk tregon përfshirje të prindit apo kujdestarit në trafikim apo abuzim dhe të menaxherit të rastit nëse ka (aneksi 9.3)	6. Punonjësi i policisë i SLKT-së dhe punonjësi i ZRSHSSH-së bëjnë me ndihmën e menaxherit të rastit (nëse ka pasur të tillë të pranishëm gjatë intervistës), analizën e intervistës duke konkluduar e personit në lidhje me trafikimin, nevojat e tij/e saj për siguri e kujdes dhe mënyrat e plotësimit të këtyre nevojave (aneksi 9.4)
	7. G/SPIF-ja bën me ndihmën e prindit/kujdestarit dhe menaxherit të rastit (nëse ka pasur të tillë të pranishëm gjatë intervistës), analizën e intervistës duke konkluduar për statusin e të miturit/të miturës në lidhje me trafikimin, nevojat e tij/saj për siguri e kujdes dhe mënyrat e plotësimit të këtyre nevojave (aneksi 9.4)	7. Punonjësi social i ZRSHSSH-së informon anëtarin e AP-së nga MPÇSSHB-ja për situatën e personit dhe konsultohet me të për rivendosjen e tij/e saj në një ambient të përshtatshëm për nevojat e tij/e saj nëse gjykohet se ka nevojë për rivendosje të personit
	8. Punonjësi social i ZRSHSSH-së informon anëtarin e AP-së nga MPÇSSHB-ja për situatën e të miturit/të miturës dhe konsultohet me të për vendosjen e të miturit/të miturës në një ambient të përshtatshëm për nevojat e tij/saj (rivendosjen nëse gjykohet se ka nevojë për rivendosje të të miturit/të miturës)	8. Punonjësi i policisë i SLKTP-së dhe punonjësi social (G/SPIF) e ndihmojnë personin të marrë një vendim dhe të deklarojë me shkrim vendimin e tij/saj të informuar për ndihmën, përfshirë rivendosjen/ndryshimin e akomodimit (aneksi 9.6)
		Në rast të vendimit për akomodim në një institucion publik apo privat të licencuar të përkujdesjes shoqërore
	9. Punonjësi i policisë i SLKTP-së dhe punonjësi social e ndihmojnë të miturin/të miturën dhe prindin apo kujdestarin e tij/e saj të marrin një vendim dhe të deklarojnë me shkrim	9. G/SPIF-ja kontakton me punonjësin e institucionit të përkujdesit shoqëror të ofruar nga AP-ja për ndihmë dhe të pranuar nga personi dhe organizon transportin e sigurt të

	Identifikimi formal i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
	vendimin e tyre të informuar për ndihmën (për ndryshimin e akomodimit vendosjes, aneksi 9.6)	personit në institucion
	Në rast të vendimit për akomodim në një institucion publik apo privat të licencuar të përkujdesjes shoqërore	
	10. G/SPIF-ja kontakton me punonjësin e institucionit të përkujdesit shoqëror të ofruar nga AP-ja për ndihmë dhe të pranuar nga i mituri/e mitura dhe kujdestari apo prindi dhe organizon transportin e sigurt të miturit/të miturës në institucion	10. G/SPIF-ja prezanton personin te punonjësi i qendrës së kujdesit për viktimat e trafikimit, ose të qendrës rezidenciale të përkujdesit shoqëror dërguar nga AP-ja
	11. G/SPIF-ja prezanton të miturin/ të miturën te punonjësi i qendrës së kujdesit për viktimat e trafikimit, ose të qendrës rezidenciale të përkujdesit shoqëror për të mitur të autorizuar e dërguar nga AP-ja	11. G/SPIF dorëzon te punonjësi i qendrës së kujdesit për viktimat e trafikimit ose i qendrës rezidenciale të përkujdesit shoqëror një kopje të konkluzioneve të intervistës dhe bien dakord me të për komunikimin dhe hapat e mëtejshëm për ndihmën dhe mbrojtjen e personit
	12. G/SPIF dorëzon te punonjësi i qendrës së kujdesit për viktimat e trafikimit ose i qendrës rezidenciale të përkujdesit shoqëror për të mitur një kopje të konkluzioneve të intervistës dhe bien dakord me të për komunikimin dhe hapat e mëtejshëm për ndihmën dhe mbrojtjen të miturit/ të miturës	12. Punonjësi i Policisë i SLKTP-së organizon shoqërimin e personit në vendin e akomodimit në rast se vlerësohet se vetë personi dhe personat që kujdesen për të rrezikohen gjatë udhëtimit
	13. G/SPIF-ja jep të miturin/ të miturën te punonjësi i qendrës ku do shkojë i mituri/e mitura (aneksi 9.8)	13. Me mbylljen e intervistës dhe largimin e personit të intervistuar G/SPIF-ja harton relacionin për AP-në (aneksi 9.9)
	14. Punonjësi i Policisë i SLKTP-së (i G/SPIF-së) organizon shoqërimin e të miturit/të miturës për në vendin e akomodimit në rast se vlerësohet se i mituri/e mitura dhe personat që kujdesen për të rrezikohen gjatë udhëtimit	14. Punonjësi i policisë i SLKTP-së nis veprimet për ndjekjen e çështjes sipas procedurës

	Identifikimi formal i të miturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)	Identifikimi formal i të rriturve në territor (të huaj dhe shqiptarë)
		Në rast të vendimit për kthim në familje apo jetë të pavarur
	15. Me mbylljen e intervistës dhe largimin e personit të mitur të intervistuar G/SPIF-ja harton relacionin për AP-në (aneksi 9.9)	9. G/SPIF i jep personit informacion se ku duhet të drejtohet në rast rreziku në komunitetin
	16. Punonjësi i policisë i SLKTP-së nis veprimet për ndjekjen e çështjes sipas procedurës	10. G/SPIF-ja informon personin se për situatën e tij/e saj do të njoftohet ZRSHSSH-ja në komunitetin ku do të banojë
	Në rast të vendimit për kthim në familje	
	10. G/SPIF japin të miturin/të miturën te familja (aneksi 9.7)	11. G/SPIF-ja personin për detyrat e ZRSHSSH-së për dhënien dhe ndërmjetësimin e ndihmës për VMT dhe VT në vendin ku do të banojë (përfshirë ndihmën për kthim në vendin e origjinës në rastin e të huajit/të huajës VMT ose VT)
	11. G/SPIF-ja i jep të miturit/të miturës dhe prindit/kujdestarit ligjor informacion se ku duhet të drejtohen në rast rreziku në komunitetin ku banojnë	12. Me largimin e personit, G/SPIF-ja harton një relacion të procesit të kryer dhe e dërgon tek AP (aneksi 9.9)
	12. G/SPIF-ja informon të miturin/të miturën dhe prindin/kujdestarin ligjor se për situatën e të miturit do të njoftohet ZRSHSSH-ja në komunitetin ku banojnë	13. Punonjësi i policisë i SLKTP-së bën veprimet e nevojshme për fillimin e çështjes penale ndaj trafikantit/trafikantëve
	13. G/SPIF-ja informon të miturin/të miturën dhe prindin/kujdestarin ligjor për detyrat e ZRSHSSH-së për dhënien dhe ndërmjetësimin e ndihmës për VMT dhe VT në vendin ku banojnë	
	14. Me largimin e personit të mitur të intervistuar G/SPIF-ja harton një relacion të procesit të kryer dhe e dërgon tek AP-ja (aneksi 9.9)	
	15. Punonjësi i policisë i SLKTP-së bën veprimet e nevojshme për fillimin e çështjes penale ndaj trafikantit/trafikantëve	

7.3 Identifikimi dhe referimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

7.3.1 Identifikimi dhe referimi fillestar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

	Identifikimi fillestar i të miturve shqiptarë	Identifikimi fillestar i të rriturve shqiptarë
Qëllimi	Të identifikohen viktimat e mundshme të mitur shqiptarë, të kërkohe bashkëpunimi i strukturave ndihmëse homologe, strukturave policore etj., në vendin pritës në mënyrë që të shpëtohen ata/ato nga trafikimi e shfrytëzimi, të evitohet ndëshkimi dhe penalizimi i tyre, të njoftohet autoriteti përgjegjës, e të aktivizohen hallkat e mëtejshëm për kthimin e të miturve viktimat të mundshme trafikimi nëse dëshirojnë dhe nuk rrezikohet mirëqenia e tyre	Të identifikohen viktimat e mundshme të rritur shqiptarë, të kërkohe bashkëpunimi i strukturave ndihmëse homologe, strukturave policore etj., në vendin pritës në mënyrë që të shpëtohen ata/ato nga trafikimi e shfrytëzimi, të evitohet ndëshkimi dhe penalizimi i tyre, të sigurohet plotësimi i nevojave bazë të tyre, të njoftohet autoriteti përgjegjës, e të aktivizohen hallkat e mëtejshëm për kthimin e personave viktimat të mundshme trafikimi nëse dëshirojnë dhe nuk rrezikohet mirëqenia e tyre
Treguesit e suksesit	Numri i të miturve të identifikuar si viktimat të mundshme të trafikimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë	Numri i personave të rritur të identifikuar si viktimat të mundshme të trafikimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë
	Numri i të miturve viktimat të mundshme të trafikimit të ndihmuar	Numri i personave të rritur viktimat të mundshme të trafikimit të ndihmuar
Metoda e identifikimit	Vlerësim i informacionit të marrë nga intervistat për qëllime të shërbimeve konsullore, nga individë të veçantë apo agjenci shtetërore dhe joshtetërore të ndihmës në vendin pritës, kundrejt treguesve të trafikimit (treguesit e trafikimit të të miturve si në territorin e Republikës së Shqipërisë)	Vlerësim i informacionit të marrë nga intervistat për qëllime të shërbimeve konsullore, nga individë të veçantë apo agjenci shtetërore dhe joshtetërore të ndihmës në vendin pritës, kundrejt treguesve të trafikimit (treguesit e trafikimit të të rriturve si në territorin e Republikës së Shqipërisë)
Përgjegjës i drejtpërdrejtë/kush e bën	Punonjësit e përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë (PDRSH) me këtë rend: Oficerët e kontaktit Nuk ka: Nëpunësi konsullor Nuk ka: Anëtari i shërbimit diplomatik i	Punonjësit e përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë (PDRSH) me këtë rend: Oficerët e kontaktit Nuk ka: Nëpunësi konsullor Nuk ka: Anëtari i shërbimit diplomatik i

	Identifikimi fillestar i të miturve shqiptarë	Identifikimi fillestar i të rriturve shqiptarë
	ngarkuar me funksione konsullore	ngarkuar me funksione konsullore
Monitorues i drejtpërdrejtë i procesit	Anëtarë të autoritetit përgjegjës nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë	Anëtarë të autoritetit përgjegjës nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë
Koha	E pakufizuar por sa më shpejt që është e mundur pas rënies në kontakt me të miturin viktimë e mundshme apo marrjes së informacionit se një i mitur/e mitur mund të jetë viktimë e trafikimit	E pakufizuar por sa më shpejt që është e mundur pas rënies në kontakt me viktimën e mundshme apo marrjes së informacionit se një person mund të jetë viktimë e trafikimit
Vendi i identifikimit	Zyrat e përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë	Zyrat e përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë
Dokumentimi i procesit	Njoftimi me shkrim i autoritetit përgjegjës në një (1) origjinal i cili i dërgohet AP-së, dhe një (1) kopje e cila mbahet nga zyra konsullore	Njoftimi me shkrim i autoritetit përgjegjës në një (1) origjinal i cili i dërgohet AP-së, dhe një (1) kopje e cila mbahet nga zyra konsullore
	Listë dhe informacion i azhurnuar mbi autoritetet që bëjnë identifikimin dhe japin mbrojtje për viktimat e trafikimit ose viktimat e mundshme të trafikimit të mitur në vendin pritës	Listë dhe informacion i azhurnuar mbi autoritetet që bëjnë identifikimin dhe japin mbrojtje për viktimat e trafikimit ose viktimat e mundshme të trafikimit të rritur në vendin pritës
	Çdo lloj dokumenti tjetër që vërteton se punonjësi i PDRSH-së ka bërë përpjekje për vlerësim të situatës dhe ndërhyrje për ta shpëtuar personin kur ka dyshuar apo ka marrë informacion se personi shtetas shqiptar mund të jetë trafikuar	Çdo lloj dokumenti tjetër që vërteton se punonjësi i PDRSH-së ka bërë përpjekje për vlerësim të situatës dhe ndërhyrje për ta shpëtuar personin kur ka dyshuar apo ka marrë informacion se personi shtetas shqiptar mund të jetë trafikuar
Hapat	1. Punonjësi i PDRSH-së vlerëson se i mituri/e mitura është viktimë e mundshme e trafikimit (VMT) nëpërmjet informacionit nga i mituri/e mitura persona të afërt me të ose merr njoftimin për këtë nga agjenci të vendit pritës	1. Punonjësi i PDRSH-së vlerëson se personi me shtetësi shqiptare është viktimë e mundshme e trafikimit nëpërmjet informacionit nga vetë ai/ajo, persona të afërt me të ose merr njoftimin për këtë nga agjencitë e vendit pritës
	2. Punonjësi i PDRSH-së njofton AP-në menjëherë për identifikimin e viktimës së mundshme të mitur	2. Punonjësi i PDRSH-së njofton AP-në menjëherë për identifikimin e viktimës së mundshme të rritur
	Në rast se nuk ka informacion për përfshirjen e prindit apo	

	Identifikimi fillestar i të miturve shqiptarë	Identifikimi fillestar i të rriturve shqiptarë
	kujdestarit ligjor në trafikimin/shfrytëzimin e të miturit/të miturës	
	3. Punonjësi i PDRSH-së merr kontakt me të miturin dhe kujdestarin e tij/saj (nëse kujdestari prindi/kujdestari ligjor është në Shqipëri apo vend tjetër AP kontakton me të) dhe vlerëson nevojat dhe pritjet e të miturit/të miturës dhe prindit/kujdestarit për kujdes dhe mbrojtje	3. Punonjësi i PDRSH-së merr kontakt me personin dhe vlerëson nevojat dhe pritjet e personit për kujdes dhe mbrojtje
	4. Punonjësi i PDRSH-së merr informacion mbi procesin e identifikimit ose bashkëpunimit të viktimave të trafikimit dhe mundësitë e ndihmës në vendin pritës dhe e jep këtë informacion tek i mituri/e mitura dhe kujdestari i tij/e saj ligjor dhe i ndihmon ata të marrin një vendim	4. Punonjësi i PDRSH-së merr informacion mbi procesin e identifikimit ose bashkëpunimit të viktimave të trafikimit dhe mundësitë e ndihmës në vendin pritës dhe e jep këtë informacion te personi dhe e ndihmon atë të marrë një vendim
	Në rast se i mituri/e mitura dhe kujdestari i tij/e saj ligjor vendosin që i mituri/e mitura të qëndrojnë në vendin pritës	Në rast se personi dëshiron të qëndrojë në vendin pritës
	5. Punonjësi i PDRSH-së vendos kontakte me agjencitë përgjegjëse për identifikim dhe ndihmë dhe lehtëson procesin e identifikimit dhe ndihmës së të miturit në vendin pritës	5. Punonjësi i PDRSH-së vendos kontakte me agjencitë përgjegjëse për identifikim dhe ndihmë dhe lehtëson procesin e identifikimit dhe ndihmës në vendin pritës
	6. Punonjësi i PDRSH-së harton relacione të rregullta çdo 6 muaj për AP-në për situatën e të miturit në vendin pritës (deri sa i mituri/e mitura mbush moshën 18 vjeç)	6. Punonjësi i PDRSH-së harton relacione të rregullta çdo 6 muaj për AP-në për situatën e personit në vendin pritës
	Në rast se i mituri/e mitura dhe kujdestari i tij/e saj ligjor vendosin që i mituri të kthehet në Shqipëri	Në rast se personi dëshiron të kthehet në Shqipëri
	5. Punonjësi i PDRSH-së, i kërkon autoritetit përgjegjës ndihmë për kthimin e të miturit përfshirë vlerësimin e situatës familjare dhe rrezikut për të miturin/të miturën në kthim	5. Punonjësi i PDRSH-së, i kërkon autoritetit përgjegjës ndihmë për kthimin vullnetar të personit
	6. Punonjësi i PDRSH-së, në bashkëpunim me autoritetet vendase dhe organizatat e ndryshme jofitimprurëse merr masa për vendosjen e të miturit/të	6. Punonjësi i PDRSH-së bashkëpunon me AP-në për organizimin e kthimit vullnetar të personit viktimë e mundshme

	Identifikimi fillestar i të miturve shqiptarë	Identifikimi fillestar i të rriturve shqiptarë
	miturës në një ambient të sigurt e të përshtatshëm deri në kthim	
		7. Punonjësi i PDRSH-së ndihmon personin për gjetjen dhe akomodimin në një ambient të sigurt e të përshtatshëm deri në kthim
	Në rast se kthimi konfirmohet si i sigurt	
	7. Punonjësi i PDRSH-së bashkëpunon me AP-në për organizimin e kthimit të të miturit/të miturës	
	Në rast se kthimi nuk konfirmohet si i sigurt	
	7. Punonjësi i PDRSH-së merr kontakt me autoritetet ndihmëse në vendin pritës për gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme dhe afatgjate për të miturin në vendin pritës	
	8. Punonjësi i PDRSH-së harton relacione të rregullta çdo 6 muaj për AP-në për situatën e të miturit në vendin pritës	
	Në rast se ka informacion për përfshirjen e kujdestarit ligjor në shfrytëzimin e të miturit/të miturës	
	3. Punonjësi i PDRSH-së merr kontakt me të miturin/të miturën dhe vlerëson nevojat dhe pritjet e të miturit/të miturës për kujdes dhe mbrojtje	
	4. Punonjësi i PDRSH-së konsultohet me AP-në për hapat e mëtejshëm të ndërhyrjes për kujdesin dhe mbrojtjen e të miturit	
	5. Punonjësi i PDRSH-së ndërmerr hapat për kujdes dhe mbrojtje të të miturit sipas konsultimit me AP-në	
Tregues të trafikimit	Për të mitur jashtë territorit (referoju listës së treguesve në territor)	Për të rritur jashtë territorit (referoju listës së treguesve në territor)

7.3.2 Identifikimi formal jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

	Identifikimi formal i të miturve shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë	Identifikimi formal i të rriturve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë
Qëllimi	Të identifikohen viktimat e trafikimit të mitur shqiptarë, të bashkëpunohet me strukturat ndihmëse homologe, strukturave policore etj. në vendin pritës në mënyrë që të shpëtohen ata/ato nga trafikimi e shfrytëzimi, të evitohet ndëshkimi dhe penalizimi i tyre e të aktivizohen hallkat e mëtejshëm për kthimin e personave viktimat të mundshme apo viktimat trafikimi nëse dëshirojnë dhe nuk rrezikohet mirëqenia e tyre	Të identifikohen viktimat e trafikimit të rritur shqiptarë, të bashkëpunohet me strukturat ndihmëse homologe, strukturave policore etj. në vendin pritës në mënyrë që të shpëtohen ata/ato nga trafikimi e shfrytëzimi, të evitohet ndëshkimi dhe penalizimi i tyre e të aktivizohen hallkat e mëtejshëm për kthimin e personave viktimat trafikimi nëse dëshirojnë dhe nuk rrezikohet mirëqenia e tyre
Treguesit e suksesit	Numri i të miturve shtetas shqiptarë viktimat të trafikimit të ndihmuar në bashkëpunim me strukturat homologe në vendin pritës	Numri i të rriturve shtetas shqiptarë viktimat të trafikimit të ndihmuar në bashkëpunim me strukturat homologe në vendin pritës
Metoda e identifikimit	Kërkesa të rregullta për informacion drejtuar autoriteteve përgjegjëse për identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave në vendet pritëse dhe pritje informacioni prej tyre, pritje e informacionit nga agjencitë dhe organizatat në vend që kanë dijeni për viktimat trafikimi shtetas shqiptarë të identifikuar jashtë vendit që kanë nevojë për ndihmë nga autoritetet shqiptare	Kërkesa të rregullta për informacion drejtuar autoriteteve përgjegjëse për identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave në vendet pritëse dhe pritje e informacionit nga agjencitë dhe organizatat në vend që kanë dijeni për viktimat trafikimi shtetas shqiptarë të identifikuar jashtë vendit që kanë nevojë për ndihmë nga autoritetet shqiptare
Përgjegjës i drejtpërdrejtë/kush e bën	Anëtarë të AP-së nga MPJ-ja	Anëtarë të AP-së nga MPJ-ja
Monitorues i drejtpërdrejtë i procesit	Drejtuuesi i radhës i AP-së	Drejtuuesi i radhës i AP-së
Koha	Kërkesa për informacion nga autoritetet e vendit pritës: çdo tre muaj. Pritja e informacionit të rastësishëm nga autoritetet e vendit pritës: e vazhdueshme, pa kufizim	Kërkesa nga autoritetet e vendit pritës: çdo tre muaj. Pritja e informacionit të rastësishëm nga autoritetet e vendit pritës: e vazhdueshme, pa kufizim
Vendi i identifikimit/informimit	Zyrat e punonjësve të AP-së nga MPJ-ja	Zyrat e punonjësve të AP-së nga MPJ-ja
Dokumentimi i procesit	Listë e azhurnuar e autoriteteve përgjegjëse për identifikimin e	Listë e azhurnuar e autoriteteve përgjegjëse për

	Identifikimi formal i të miturve shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë	Identifikimi formal i të rriturve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë
	viktimave të trafikimit në vendet pritëse; Kërkesat për informacion; Çdo lloj dokumenti apo informacioni mbi viktimat e trafikimit i ardhur nga autoritetet përgjegjëse për identifikim të vendeve pritëse	identifikimin e viktimave të trafikimit në vendet pritëse; Kërkesat për informacion; Çdo lloj dokumenti apo informacioni mbi viktimat e trafikimit i ardhur nga autoritetet përgjegjëse për identifikim të vendeve pritëse
Hapat	1. Anëtari i AP-së nga MPJ-ja bën kërkesë zyrtare tek autoritetet përgjegjëse për identifikimin e viktimave të trafikimit në vendet pritëse	1. Anëtari i AP-së nga MPJ-ja bën kërkesë zyrtare tek autoritetet përgjegjëse për identifikimin e viktimave të trafikimit në vendet pritëse
	2. Anëtari i AP-së nga MPJ-ja informon drejtuesin e radhës të AP-së për informacionet e marra në përgjigje të kërkesave	2. Anëtari i AP-së nga MPJ-ja informon drejtuesin e radhës të AP-së për informacionet e marra në përgjigje të kërkesave
	3. Anëtari i AP-së nga Drejtoria Konsullore e MJ-së kërkon mbledhje të AP-së për rastet e të miturve viktimat të trafikimit, për të cilat kërkohet ndihma e autoriteteve shqiptare	3. Anëtari i AP-së nga Drejtoria Konsullore e MJ-së kërkon mbledhje të AP-së për rastet e të miturve viktimat të trafikimit, për të cilat kërkohet ndihma e autoriteteve shqiptare

8. NDIHMA PËR KTHIM VULLNETAR DHE MONITORIMI I NDIHMËS NË KOMUNITET

8.1 Ndhimja për kthim vullnetar të viktimave të trafikimit

8.1.1 Ndhimja për kthim vullnetar të shtetasve shqiptarë të identifikuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

	Kthimi vullnetar të të miturve shqiptarë në Shqipëri	Kthimin vullnetar të të rriturve shqiptarë në Shqipëri
Qëllimi	Të zbatohet vullneti i viktimit të trafikimit të mitur për kthim në Shqipëri dhe të sigurohet mbrojtja, rehabilitimi dhe riintegrimi i tij/e saj	Të zbatohet vullneti i viktimit të rritur për kthim në Shqipëri dhe të sigurohet mbrojtja, rehabilitimi dhe riintegrimi i tij/e saj
Treguesit e suksesit	Numri i të miturve shtetas shqiptarë, viktimat të mundshme trafikimi (VNT) ose viktimat të trafikimit (VT) të ndihmuar të kthehen dhe rehabilitohen në një mjedis të përshtatshëm e të mbrojtur në Shqipëri	Numri i të miturve shtetas shqiptarë, viktimat të mundshme trafikimi ose viktimat të trafikimit (VT) të ndihmuar të kthehen dhe rehabilitohen në një mjedis të përshtatshëm e të mbrojtur në Shqipëri
Metoda	Mbledhja, analiza, shkëmbimi i	Mbledhja, analiza, shkëmbimi

	Kthimi vullnetar të të miturve shqiptarë në Shqipëri	Kthimin vullnetar të të rriturve shqiptarë në Shqipëri
	informacionit, dhe veprime të ngritjes së fondeve organizimit të udhëtimit dhe pritjes së të miturit/të miturës	i informacionit, dhe veprime të ngritjes së fondeve organizimit të udhëtimit dhe pritjes së të miturit/të miturës
Përgjegjës i drejtpërdrejtë/kush e bën	Anëtarët e autoritetit përgjegjës nga MPJ-ja	Anëtarë të autoritetit përgjegjës nga MPJ-ja
Monitorues i drejtpërdrejtë i procesit	Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim	Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim
Koha	Maksimumi 1 muaj nga kërkesa për kthim vullnetar të ndihmuar të të miturit viktimë e mundshme ose viktimë trafikimi	Maksimumi 1 muaj nga kërkesa për kthim vullnetar të ndihmuar të personit viktimë e mundshme ose viktimë trafikimi
Vendi	Zyrat e anëtarëve të AP-së	Zyrat e anëtarëve të AP-së
Dokumentimi i procesit	Listë e azhurnuar e kontakteve të zyrave rajonale të shërbimit social shtetëror për vlerësimin para kthimit	Listë e azhurnuar e kontakteve të zyrave rajonale të shërbimit social shtetëror për vlerësimin para kthimit
	Kërkesë tek AP-ja për ndihmë për kthim (aneksi 9.16)	Kërkesë tek AP-ja për ndihmë për kthim (aneksi 9.16)
	Informacion tek AP-ja në mbështetje të kërkesës për kthim vullnetar të asistuar (aneksi 9.17)	Informacion tek AP-ja në mbështetje të kërkesës për kthim vullnetar të asistuar (aneksi 9.17)
	Dokumente që vërtetojnë komunikimin dhe bashkëpunimin me një strukturë ndihmëse në vendin ku ndodhet i mituri/e mitura për qëndrimin e përkohshëm të sigurt para kthimit (p.sh. kopje të relacionit të PDRSH-së)	Dokumente që vërtetojnë komunikimin dhe bashkëpunimin me një strukturë ndihmëse në vendin ku ndodhet personi viktimë e mundshme për qëndrimin e përkohshëm të sigurt para kthimit (p.sh. kopje të relacionit të PDRSH-së)
	Dokumenti i identifikimit/udhëtimit (në rast se ka nevojë)	Dokumenti i identifikimit/udhëtimit (në rast se ka nevojë)
	Dokumente që njohin e shtetësinë shqiptare të të miturit (në rast se ka nevojë)	Dokumente që njohin e shtetësinë shqiptare të personit (në rast se ka nevojë)
	Kërkesa e AP-së për vlerësimin social ekonomik dhe sigurisë në kthim (aneksi 9.18)	Kërkesa e AP-së për vlerësimin social ekonomik dhe sigurisë në kthim (aneksi 9.18)
	Raport i vlerësimit të situatës social ekonomike dhe sigurisë së të miturit në kthim (aneksi 9.19)	Raport i vlerësimit të situatës social ekonomike dhe sigurisë së personit në kthim (aneksi 9.19)
Autorizim i prindit/kujdestarit të të miturit/të miturës për	Vlerësimi i gjendjes shëndetësore të personit para	

	Kthimi vullnetar të të miturve shqiptarë në Shqipëri	Kthimin vullnetar të të rriturve shqiptarë në Shqipëri
	kthim (aneksi 9.20)	kthimit (raport i institucionit ku ndodhet personi nëse është në një institucion)
	Autorizim i prindërve/ kujdestarit për udhëtimin e të miturit/të miturës (aneksi 9.21)	Çdo lloj dokumenti që provon organizimet e bëra për kthimin vullnetar të sigurt të personit
	Vlerësimi i gjendjes shëndetësore të të miturit/të miturës para kthimit (raport i institucionit ku ndodhet i mituri/e mitura nëse i mituri/e mitura është në një institucion)	
	Dokumenti i marrjes në kujdes të të miturit/të miturës nga familja (aneksi 9.7) apo institucioni (aneksi 9.8)	
	Çdo lloj dokumenti që provon organizimet e bëra për kthimin vullnetar të sigurt të të miturit	
Hapat	1. Anëtari i AP-së nga MPJ-ja që merr kërkesën për ndihmë në kthimin e të miturit/të miturës dhe informacionin nga institucioni/agjencia në mbështetje të kërkesës kërkon mbledhjen e AP-së për rastin	1. Anëtari i AP-së nga MPJ/MJ-ja që merr kërkesën për ndihmë për kthimin dhe informacionin nga institucione/agjenci në mbështetje të kërkesës kërkon mbledhjen e AP-së për rastin
	Shënim. Çdo kërkesë për kthim në Shqipëri të të miturve shqiptarë të konsideruar viktime të mundshme trafikimi, të mitur në rrezik trafikimi apo viktime të trafikimit (në varësi të kategorizimeve të bëra lidhur me trafikimin në vendet pritëse) do t'i dërgohet menjëherë për veprim një anëtari të AP nga MPJ ²³	Shënim. Çdo kërkesë për kthim në Shqipëri të shtetasve të rritur shqiptarë të konsideruar viktime të mundshme trafikimi, në rrezik trafikimi apo viktime të trafikimit (në varësi të kategorizimeve të bëra lidhur me trafikimin në vendet pritëse) do t'i dërgohet menjëherë për veprim një anëtari të AP-së nga MPJ-ja ²⁴
	2. Anëtari i AP-së nga MPJ-ja përgatit kërkesën për vlerësimin e situatës social ekonomike dhe sigurisë së të miturit në kthim dhe ia dërgon atë ZRSHSSH-së	2. Anëtari i AP-së përgatit kërkesën për vlerësimin e situatës social ekonomike dhe sigurisë së personit në kthim (nëse personi dëshiron një vlerësim të tillë) dhe ia dërgon atë ZRSHSSH-së

²³ P.sh. kërkesa drejtuar Zyrës së Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, Njësisë Antitrafik në MB, apo institucioneve të tjera shtetërore dhe joshtetërore që veprojnë në Shqipëri

²⁴ P.sh. kërkesa drejtuar Zyrës së Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, Njësisë Antitrafik në MB, apo institucioneve të tjera shtetërore dhe joshtetërore që veprojnë në Shqipëri

	Kthimi vullnetar të të miturve shqiptarë në Shqipëri	Kthimin vullnetar të të rriturve shqiptarë në Shqipëri
	Në rast se raporti i vlerësimit i ZRSHSSH konfirmon se kthimi në familje apo në një institucion të përkujdesjes për të mitur në Shqipëri është i sigurt dhe i përshtatshëm	Në rast se raporti i vlerësimit i ZRSHSSH-së konfirmon se kthimi në familje apo në një institucion të përkujdesjes në Shqipëri i sigurt dhe i përshtatshëm
	3. Anëtari i AP-së nga MPJ-ja konsultohet me drejtuesin e radhës së AP-së dhe anëtarët e tjerë të AP-së dhe ndërmerr veprime së bashku me ta për: Sigurimin e fondeve për udhëtimin e të miturit/të miturës dhe shoqëruesit të tij/saj në udhëtim; Sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për udhëtimin e të miturit/të miturës	3. Anëtari i AP-së konsultohet me drejtuesin e radhës së AP-së dhe anëtarët e tjerë të AP-së dhe ndërmerr veprime së bashku me ta për: Sigurimin e fondeve për udhëtimin e personit; Sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për udhëtimin/kthimin e personit
	4. Anëtari i AP-së nga MPJ-ja merr kontakt me prindërit/ kujdestarin ligjor të të miturit/të miturës dhe merr autorizimin e prindërve/kujdestarit ligjor për udhëtimin e të miturit/të miturës	4. Anëtari i AP-së nga MPJ-ja merr kontakt me institucionin/ agjencinë ku po ndihmohet personit dhe personin vetë, (drejtpërdrejt, nëpërmjet punonjësit të PDRSH në vendin pritës apo institucionit nga ka ardhur mbështetja e kërkesës për kthim të asistuar), komunikon organizimet e bëra për kthimin dhe kërkon një vlerësim të gjendjes shëndetësore të personit (nëse është i/e aftë për të udhëtuar)
Për përshkrimin e situatës në momentin e vlerësimit referojuni kategorizimeve dhe përshkrimeve tek udhëzuesit për standardet e qendrave rezidenciale.

Mirë: Nuk ka probleme shëndetësore të tanishme që mund të paraqesin shqetësim. Personi nuk ka më shumë se kollë, të ftohur apo grip dhe këto ose nuk ndodhin shpesh ose nuk zgjatin më shumë se sa pritet. Nuk ka probleme të vazhdueshme që të ndikojnë mbi shkollën, trajnimin, punën apo marrëdhëniet sociale dhe nuk ka sjellje të rrezikshme shëndetësore. Aftësitë e kufizuara nuk prekin punën, lojën apo marrëdhëniet sociale. Personi ha mirë dhe shfaq një dietë të shëndetshme dhe ushtrim fizik. Personi nuk shfaq shenja të sëmundjeve mendore apo depresionit.

Kënaqshëm: Personi është në përgjithësi mirë por mund të vuajë shpesh sëmundje të lehta. Megjithatë, problemet e menjëhershme shëndetësore mund të trajtohen pothuajse gjithmonë nga vetë personi dhe ata që kujdesen për të. Problemet kronike shëndetësore, sëmundjet mendore dhe aftësitë e kufizuara menaxhohen mirë dhe nuk ndikojnë mbi shkollën, punën dhe marrëdhëniet sociale. Personi po merr përkujdesje për çdo problem shëndetësor që kërkon mjekim të rregullt apo kontrolle të rregullta nga ana e shërbimeve mjekësore të specializuara. Personi nuk shfaq shenja depresioni.

Disa vështirësi: Personi ka disa probleme shëndetësore të vazhdueshme apo të përsëritura akute që ndikojnë mbi shkollën, trajnimin, punën apo veprimtarinë sociale. Këto mund të përfshijnë

periudha të shpeshta astme, ekzema të rënda, alergji, probleme të frymëmarrjes dhe kardiake, ose depresion. Problemet kronike shëndetësore dhe aftësitë e kufizuara kërkojnë ndërhyrje të shpeshta dhe po ndikojnë mbi rutinën dhe marrëdhëniet sociale të përfituesit. Personi ka vështirësi në aksesin në kujdes shëndetësor ose mjekim për kushte mjekësore akute ose kronike. Një veçori përcaktuese është ekzistenca e disa kufizimeve të jetës së përditshme.

Vështirësitë për momentin i tejkalojnë pikat e forta: Personi ka probleme të mëdha akute apo kronike shëndetësore që kërkojnë ndërhyrje të vazhdueshme mjekësore dhe/ose ndihmë të veçantë nga kujdestarët. Aftësitë e kufizuara nuk janë trajtuar siç duhet. Personi shfaq shenja të depresionit apo të vetëvrasjes së mundshme. Problemet shëndetësore dhe/ose fizike të përfituesit ndikojnë shumë mbi rutinën dhe/ose marrëdhëniet e tyre sociale.

Për vështirësitë e identifikuar gjatë monitorimit të rastit, përshkruani hapat që do të ndërmerren për të përmirësuar gjendjen shëndetësore të personit, personin përgjegjës, datën e rishikimit dhe treguesin e suksesit.

Shëndeti mendor

Për përshkrim e situatës në momentin e monitorimit referoju kategorizimeve dhe përshkrimeve tek udhëzuesit për standardet e qendrave rezidenciale. Kategorizimet dhe kuptimi i tyre është:

Mirëpërshtatur: Personi ka shumë pika të forta dhe nuk shfaq shenja të problemeve emocionale apo psikologjike. Personi ka një kuptim të qartë të aftësive dhe kufizimeve të tij/saj dhe është në gjendje të ndjehet mirë për aftësitë dhe të mos shqetësohet për kufizimet. Personi shkon mirë me të tjerët dhe ka marrëdhënie pozitive me familjen dhe miqtë. Ai/ajo është i ndjeshëm ndaj ndjenjave të të tjerëve dhe është në gjendje të përshtatë sjelljen e tij/saj sipas situatës dhe rrethanave. Sjellja e personit nuk ka ndikim negativ mbi punën apo aktivitetin social të tij/saj.

Kënaqshëm: Gjendja psiko-sociale e personit është në përgjithësi pozitive dhe personi shfaq një numër pikash të forta dhe vetëm disa vështirësi të cilat mund të shihen si kalimtare (p.sh., një reagim ndaj ngjarjeve të kohëve të fundit). Personi ka një mendim përgjithësisht pozitiv për veten dhe mendon që ka aftësi dhe veti personale të cilat pëlqehen nga njerëzit e tjerë. Personi zakonisht është në gjendje të bashkohet në veprimtari dhe të bashkëpunojë me miqtë, kolegët dhe familjen. Personi ka marrëdhënie të mira sociale, por mund të shfaqë pak padurim ose mosangazhim herë pas here. Sjellja e personit nganjëherë mund të ndikojë negativisht mbi punën apo aktivitetin social të tij/saj. Vëmendja ndaj paraqitjes fizike dhe higjienës nganjëherë mund të mungojë.

Disa vështirësi: Ndërkohë që pikat e forta janë të dukshme, personi shfaq disa shenja shqetësimi emocional ose psikologjik. Sjellja sfiduese mund të jetë më e vështirë për t'u trajtuar, periudhat e hidhërimit apo mërzisë janë më të shpeshta dhe më të vështira për të vendosur kontakt, apo nervozizmi dhe hutimi mund të ndërhyjnë në disa aspekte të jetës. Personi mund të demonstrojë dyshime të vazhdueshme rreth vetes dhe vlerës së tyre. Ai/ajo mund të shqetësohet se ku bëjnë pjesë nga ana sociale dhe nëse pranohet apo pëlqehet nga familja, miqtë apo kolegët. Personi mund të duket i izoluar nga ana sociale ose sepse ai/ajo ka tendencë të tërhiqet dhe të shkëpusë marrëdhëniet ose nuk u pëlqen dhe injorohet nga të tjerët. Pamja e jashtme e personit mund të japë përshtypjen e një mungese interesi në pamjen sociale dhe higjienë ose në të kundërt një preokupim i tepërt në paraqitje.

Vështirësitë i tejkalojnë pikat e forta: Problemet i tejkalojnë pikat e forta për momentin. Ka dukshëm disa probleme shqetësuese emocionale dhe të sjelljes të cilat ndërhyjnë në jetën e personit dhe venë në dukje nevojën për këshillim apo ndihmë profesionale. Personi ka mendime të vazhdueshme negative për veten. Personi ka probleme me marrëdhëniet me familjen, marrëdhëniet sociale ose të punës, nuk është në gjendje të modifikojë veprimet e tij/saj për t'u përshtatur me të tjerët apo të harmonizojë emocionet e tij me ato të të tjerëve. Ai/ajo mund të jetë i/e tërhequr, i/e zyrtë, sfidues ose agresiv në shumë situata dhe marrëdhënie ose mund të ngrëjë zërin dhe të shkaktojë situata të sikletshme në publik. Ai/ajo ka vështirësi të përshtatë sjelljen ose paraqitjen me njerëz të ndryshëm dhe situata të ndryshme. Pamja e jashtme mund të duket qëllimisht e neglizhuar ose fyese, ose e zgjedhur për të reflektuar një nevojë për t'u shkëputur nga jeta sociale më shumë se sa për t'u përshtatur me një pjesë të saj.

Alarm: Personi shfaq shenja të depresionit të rëndë ose vetëvrasjeje të mundshme.

Për personat që shikohen që kanë vështirësi të vazhdueshme psiko-sociale, përshkruani hapat që do të ndërmerren për të përmirësuar gjendjen psiko-sociale të përfituesit, personin përgjegjës, datën e rishikimit dhe treguesin e suksesit.

Në rastet kur përfituesi shfaq shenja depresioni apo vetëvrasjeje të mundshme, parashikoni ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme, konsultoni ekspertët e duhur, diskutimet me personin duhet të mbahen vetëm nga ana e profesionistëve të trajnuar për këtë, dhe personi duhet të mbikëqyret me kujdes për të parandaluar çdo përpjekje vetëvrasjeje.

Punësimi

Për përshkrimin e situatës në momentin e monitorimit referoju kategorizimeve dhe përshkrimeve tek udhëzuesit për standardet e qendrave rezidenciale.

Kategorizimet janë:

Nuk është i interesuar: Personi është i interesuar të gjejë punësim apo të ndërmarrë trajnim profesional.

Synim i Arritur: Personi është i punësuar ose ka të ardhura nga fusha që plotëson synimet e tij/saj. Personi është i kënaqur me punën dhe të ardhurat e tij/saj.

I kënaqur: Personi ka një punësim që është i kënaqshëm por nuk i plotëson krejtësisht synimet e tij/saj. Personi mendon që të ardhurat janë të mjaftueshme.

I pakënaqur: personi është punësuar, por është i pakënaqur me punën ose me të ardhurat e tij/saj.

Në trajnim: Personi aktualisht po ndjek trajnim profesional.

I papunë: Personi dëshiron të punësohet, por aktualisht është i papunë.

Për personat që shikohen që janë të papunë ose të pakënaqur me punësimin ose të ardhurat e tyre, përshkruani hapat që do të ndërmerren për të përmirësuar gjendjen e punësimin të personit, personin përgjegjës, datën e rishikimit dhe treguesin e suksesit:

Strehimi/akomodimi

Për përshkrimin e situatës në momentin e monitorimit referoju kategorizimeve dhe përshkrimeve tek udhëzuesit për standardet e qendrave rezidenciale.

Kategorizimet dhe kuptimi i tyre është:

E zgjidhur: Personi jeton në një shtëpi të sigurt e të shëndetshme. Në shtëpi nuk ka abuzim. Banorët kanë burime të mjaftueshme për të plotësuar nevojat bazë të tyre, përfshirë ato të personit. Strehimi është i qëndrueshëm dhe personi mund të vazhdojë të banojë atje në të ardhmen e parashikueshme

Kufizime të identifikuar: Personi jeton në një strehim të pranueshëm. Megjithatë, ka disa kufizime që duhet të zgjidhen përpara se situata mund të konsiderohet e zgjidhur. Kufizimet mund të përfshijnë: konflikte në familje, mungesë burimesh për të plotësuar nevojat bazë të familjes, mungesë e të ardhurave për të paguar qiranë etj.

Transferim në një qendër: Personi ka nevoja të cilat kërkojnë kujdes afatgjatë në një qendër rezidenciale. Kjo mund të përfshijë personat me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, fëmijë që nuk mund të kthehen te shtëpia prindërore apo te një i afërm tjetër etj.

Kërkon një plan për strehim të pavarur: Personi vazhdon të kërkojë një zgjidhje jetese të pavarur.

Për vështirësitë e identifikuar gjatë monitorimit të rastit, përshkruani hapat që do të ndërmerren për të përmirësuar akomodimin e personit, personin përgjegjës, datën e rishikimit dhe treguesin e suksesit.

Familja

Për përshkrim e situatës në momentin e monitorimit referoju kategorizimeve dhe përshkrimeve tek udhëzuesit për standardet e qendrave rezidenciale.

Kategorizimet janë:

E zgjidhur: Personi është i kënaqur me marrëdhënien që ka me familjen e tij/saj.

Kufizime: Personi ka një marrëdhënie me familjen por ka kufizime në këtë marrëdhënie. Këto kufizime mund të përfshijnë konflikte në familje, probleme ekonomike, ndarja gjeografike etj.

Asnjë kontakt: Personi është i/e rritur dhe nuk dëshiron të ketë kontakte të mëtejshme me familjen e tij/saj.

Për personat që shikohen që kanë kufizime në marrëdhëniet e tyre familjare, përshkruani hapat që do të ndërmerren për të përmirësuar ato, personin përgjegjës, datën e rishikimit dhe treguesin e suksesit.

Shkollimi

Për përshkrim e situatës në momentin e vlerësimit referojuni kategorizimeve dhe përshkrimeve tek udhëzuesit për standardet e qendrave rezidenciale.

Kategorizimet dhe kuptimi i tyre është:

Përfunduar: Personi ka përfunduar arsimimin formal.

Ndjek me sukses: Personi ndjek shkollën dhe po përparon mirë.

Ndjek me probleme: Personi po ndjek shkollën por ka vështirësi. Vështirësitë mund të jenë akademike ose sociale.

Nuk është regjistruar–personi dëshiron të ndjekë shkollën, por nuk është regjistruar aktualisht.

Nuk është i interesuar–personi nuk dëshiron të vazhdojë arsimimin e tij/saj.

Për personat që shikohen që kanë probleme në shkollë apo në regjistrimin në shkollë, përshkruani hapat që mund të ndërmerren për të përmirësuar gjendjen e personit, personin përgjegjës, datën e rishikimit dhe treguesin e suksesit.

Emri, mbiemri dhe firma e punonjësit social

Data e shkrimit të raportit

ANEKSI 9.23

UDHËZIME PËR PËRCAKTIMIN E MOSHËS SË PERSONIT QË DYSHOHET SI I/E MITUR

Shpesh trafikantët e pajisin të miturin/të miturën e trafikuar me një pasaportë ose dokument identiteti që është i falsifikuar ose i ndryshuar për ta paraqitur atë si të rritur, ndërkohë që ata në të vërtetë janë nën 18 vjeç, e si të tillë gëzojnë të drejtat për një mbrojtje të veçantë. Për të vlerësuar nëse një person i ri në moshë mund të jetë i/e mitur e jo i/e rritur, duhen kontrolluar treguesit e mëposhtëm:

Pamja fizike dhe pjekuria e tij/e saj psikologjike;

Deklaratat e personit;

Dokumentacioni që ka ai/ajo me vete;

Në qoftë se ende nuk ka siguri për moshën e personit, duhen bërë dhe këto dy kontrole:

Një ekzaminim mjekësor prej një punonjësi profesionist të shëndetësisë, vetëm me pëlqimin e personit në fjalë dhe një të rrituri që është kujdestari i tij/e saj ligjor.

Kontakti me një ambasadë ose autoritete të tjera përgjegjëse të vendit nga duket se vjen personi i ri (qoftë ky vend tjetër apo krahinë tjetër)

Në qoftë se, pasi janë bërë të gjitha kontrollat, ende ka dyshim se personi është nën moshën 18 vjeç, këtij personi i duhet dhënë përparësia e dyshimit dhe ai duhet prezumuar se është nën moshën 18 vjeç, e për rrjedhim me të drejtë që të trajtohet dhe të mbrohet si i/e mitur.

ANEKSI 9.24

KUSHTET MINIMALE TË INTERVISTIMIT FORMAL PËR INTERVISTIMIN E TË MITURVE DHE TË RRRITURVE

Intervistimi nuk kryhet në qendrat/strehëzat ku përfituesi merr shërbimet;

Intervistimi kryhet në praninë e punonjësit social;

Intervistimi kryhet në një ambient që është i sigurt dhe i mbrojtur për personin që do të intervistohet dhe personat e tjerë që do të marrin pjesë në intervistim, larg personave që dyshohet se mund të jenë përfshirë në trafikim;

Të gjithë personat që marrin pjesë në intervistim duhet ta kenë të qartë rolin e tyre;

Intervista nuk duhet të kryhet pa qenë plotësuar më parë nevojat e menjëhershme dhe bazike të të intervistuarit (ushqimi, apo nevoja të tjera personale dhe të higjienës);

Personi që do të intervistohet nuk duhet lënë të presë gjatë;

Personat që mund të jenë viktimat të trafikimit nuk intervistohen në grup;

Personi nuk intervistohet nëse ka shenja se nuk ndjehet mirë fizikisht apo emocionalisht;
Personit i jepet ndihmë e menjëhershme mjekësore dhe psikologjike nëse konstatohet se ka nevojë për këtë;

Kurdoherë që është e mundur personi intervistohet nga persona të së njëjtës gjini;

Dera e dhomës/ambientit ku do të bëhet intervistimi mbahet e mbyllur gjatë gjithë kohës së intervistimit për të ruajtur konfidencialitetin dhe konsistencën e intervistimit dhe personit i shpjegohen qartë arsyet për këtë;

Intervistimi kryhet në mjedise/dhoma që janë mjaft larg nga dhoma ku mbahen persona të ndaluar;

Personit që intervistohet i shpjegohet qartë se ka të drejtë ta ndërpresë intervistën në momentin që ndjehet nën presion apo jo në vullnetin e vet të plotë e të lirë për t'u përgjigjur;

Në asnjë mënyrë intervista nuk ndërpritet për shkak të detyrave të tjera që dalin gjatë kohës së intervistës;

Telefonat celularë mbahen të heshtur nga të gjithë personat e pranishëm gjatë intervistës;

Personit që intervistohet dhe kujdestarit apo prindit në rastin e të miturit i shpjegohet çdo shënim që mbahet gjatë kohës së intervistimit, qëllimet për të cilat mbahen shënimet dhe i jepet informacion i kuptueshëm se si do ruhet e me kë do ndahet ky informacion;

Personit që intervistohet dhe kujdestarit apo prindit në rastin e të miturit i shpjegohet qartë procedura dhe qëllimi i intervistimit, kohëzgjatja e intervistës dhe i sigurohet që është i lirë/e lirë, ta ndërpresë intervistimin në çdo kohë;

Për intervistimin e të miturve

Intervistimi i të miturve bëhet në një ambient miqësor për fëmijët;

Intervistimi i të miturit fillon pasi është njoftuar paraprakisht prindi ose kujdestari ligjor;

I mituri/e mitura intervistohet në prani të prindit apo kujdestarit ligjor nëse nuk ka dyshime të përfshirjes së tyre në trafikim;

Në intervistën e një të mituri/të miture nuk duhet të marrin pjesë më shumë se tre të rritur;

Në komunikimin me një të mitur, intervistuesit duhet:

- Të fillojnë bisedën me pyetje të thjeshta për të thyer akullin dhe për të fituar besimin e fëmijës;

- Të sillen butë dhe qetë por të evitojnë prekjet;

- Të pyesin të miturin/të miturën nëse e kupton përse po kryhet intervista;

- Të pyesin të miturin/të miturën nëse ndihet rehat të flasë për gjëra delikate në prani të të tjerëve;

- Të mos i premtojnë diçka të miturit/të miturës në këmbim apo në fund të intervistës;

- Të mos e ndërpresin të miturin/të miturën kur flet vetëm në raste kur nuk është e qartë çfarë po thotë ai/ajo;

Përpara se të përfundojnë intervistën, t'i shpjegojë të miturit/të miturës çfarë do të ndodhë më pas me të, cilat do të jenë masat mbrojtëse ndaj tij/saj.

10 . LIGJET KRYESORE ME TË CILAT DËNOHET TRAFIKIMI DHE VEPRA TË LIDHURA ME TË DHE ASISTOHEN VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

Kodi Penal, neni 110/ a “Trafikimi i Personave”

Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga dy milionë deri në pesë milionë lekë.

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga katër milionë deri në gjashtë milionë lekë.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me

keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtë milionë deri në tetë milionë lekë.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga shtatë milionë deri në dhjetë milionë lekë.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.

Kodi Penal, neni 114/ b “Trafikimi i femrave”

Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e femrave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike a psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve, për të marrë pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga tre milionë deri në gjashtë milionë lekë.

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të femrave dënohen me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga pesë milionë deri në shtatë milionë lekë.

Kodi Penal, neni 128/b “Trafikimi i të miturve”

Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga katër milionë deri në gjashtë milionë lekë.

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet dhe me gjobë nga gjashtë milionë deri në tetë milionë lekë.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtë milionë deri në tetë milionë lekë.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga tetë milionë deri në dhjetë milionë lekë.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.

Kodi Penal, neni 124/b “Keqtrajtimi i të miturit”

Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga personi që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet.

Detyrimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij dënohet me burgim deri në katër vjet dhe me gjobë nga pesëdhjetë mijë deri në një milion lekë.

Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e të miturit, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Kodi Penal, neni 298 “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”

Strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit, ose i mjeteve të tjera të transportit apo çdo ndihmë tjetër me qëllim kalimin të paligjshëm të kufirit të Republikës së Shqipërisë ose për hyrjen e paligjshme të një personi në një shtet tjetër, pa qenë shtetas i tij ose qe nuk ka leje qëndrimi në atë shtet, përbën vepër penale (1-4 vjet burg dhe gjobë 3-6 milionë lekë).

Kur ndihma jepet për qëllime fitimi, (3-7 vjet burgim dhe gjobë 4-8 milionë lekë).

Kodi Penal, neni 117 “Pornografia”

Prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në ambientet e të miturve, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Përdorimi i të miturit për prodhimin e materialeve pornografike, si dhe shpërndarja ose publikimi i tyre në internet apo në forma të tjera, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë.

Kodi Penal, neni 114 “Shfrytëzimi i prostitucionit”

Shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Kodi Penal, neni 114/a “Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese”

Shfrytëzimi i prostitucionit i kryer:

1. me të mitur;
2. ndaj disa personave;
3. me persona me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie ose duke përfutuar nga raportet zyrtare;
4. me mashtrim, shtrëngim, dhunë ose duke përfutuar nga paaftësia fizike ose mendore e personit;
5. ndaj një personi që shtyhet ose shtrëngohet për të ushtruar prostitucion jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
6. kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose nga persona të ngarkuar me funksione shtetërore dhe publike dënohet nga 7 deri në 15 vjet burgim.

Kodi i Procedurës Penale, neni 75/a i “Kompetencat e gjykatës për krime të rënda”

(Ndryshuar me ligjin nr.9276, datë 16.9.2004, neni 4, ndryshuar me ligjin nr.9911, datë 5.5.2008)

Gjykata e krimeve të rënda gjykon krimet e parashikuara nga nenet 73, 74, 75, 79 shkronjat “c” dhe “ç”, 109, 109/b, 110/a, 111, 114/b, 128/b, 219, 220, 221, 230, 230/a, 230/b, 231, 232,233, 234, 234/a, 234/b, 278/a, 282/a, 283/a, 284/a, 287/a, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal, duke përfshirë edhe rastet kur ato janë kryer nga të miturit.

Kodi i Procedurës Penale, neni 293 “Referimi i veprës penale te prokurori”

1. Me marrjen e njoftimit për një vepër penale, policia gjyqësore, pa vonesë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë. Ajo njofton, kur është e mundur edhe gjeneralitetet, banesën dhe çdo gjë që vlen për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit.

2. Kur ka urgjencë dhe në rastet e krimeve të rënda, njoftimi bëhet menjëherë edhe me gojë.

Kodi i Procedurës Penale, neni 280 “Marrja dijani për veprën penale”

1. Prokurori dhe policia marrin dijani për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.

Kodi i Procedurës Penale, neni 281 “Kallëzimi nga nëpunësit publikë”

1. Nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dijani për një vepër penale që ndiqet kryesisht, detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepra penale.

2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore.

3. Kur, gjatë një procedimi civil ose administrativ, zbulohet një fakt që përbën vepër penale që ndiqet kryesisht, organi përkatës bën kallëzim te prokurori.

4. Kallëzimi përmban elementet thelbësore të faktit, burimet e provës, gjeneralitetet, banimin dhe çdo gjë tjetër që vlen për identifikimin e personit të cilit i atribuohet fakti, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të sqarojnë rrethanat e faktit.

Kodi i Procedurës Penale, neni 282 “Kallëzimi nga personeli mjekësor”

1. Personeli mjekësor që është i detyruar ligjërisht të bëjë kallëzim duhet ta paraqesë atë brenda dyzet e tetë orëve dhe t’ia dërgojë prokurorit ose çdo oficeri të policisë gjyqësore të vendit ku ka kryer ndërhyrjen ose ka dhënë ndihmën dhe kur ka rrezik nga vonesa, oficerit të policisë gjyqësore më të afërt.

2. Kallëzimi nga personeli mjekësor tregon personin të cilit i është dhënë ndihma dhe, kur është e mundur, gjeneralitetet, banimin e tij dhe çdo gjë tjetër që vlen për ta identifikuar, si dhe rrethanat e faktit, mjetet me të cilat është kryer dhe pasojat që ka shkaktuar.

3. Kur disa persona kanë dhënë ndihmën e tyre mjekësore për të njëjtin rast, të gjithë janë të detyruar të bëjnë kallëzim, me të drejtë që të përpilojnë dhe të nënshkruajnë një akt të vetëm.

Kodi i Procedurës Penale, neni 283 “Kallëzimi nga ana e shtetasve”

1. Çdo person që ka marrë dijeni për një veprë penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.

2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit.

3. Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 195.

Ligji nr.9749, datë 11.4.2007 “Për Policinë e Shtetit”, neni 100 “Njoftimi për paraqitje në polici”

1. Punonjësi i policisë njofton individët për t’u paraqitur në zyrat e policisë në këto raste:

- për të marrë informacion për parandalimin e një rreziku;
- për të identifikuar persona që mund të kenë dijeni për rrezikun apo incidentin;
- për të identifikuar shkelësit e mundshëm të ligjit.

2. Njoftimi për paraqitje bëhet me anë të fletënjoftimit ose edhe verbalisht, duke përcaktuar arsyen e paraqitjes, punonjësin e policisë, kohën, vendin dhe informacion për të kontaktuar punonjësin e policisë në rast pamundësie për t’u paraqitur.

3. Kur për shkak të kushteve personale dhe familjare, personi që njoftohet nuk mund të paraqitet në zyrat e policisë, punonjësi i policisë mund të shkojë ta marrë këtë informacion në vendbanimin e personit të njoftuar.

Ligji nr.9749, datë 11.4.2007 “Për Policinë e Shtetit”, neni 101 “Shoqërimi në polici”

1. Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në mjediset e policisë ose në organin urdhërdhënës në rastet e mëposhtme:

a) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;

b) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë.

2. Personat e shoqëruar kanë të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tyre. Ata njoftohen menjëherë nga punonjësi i policisë për shkaqet e shoqërimit.

3. Personat e shoqëruar mbahen në mjedise të ndryshme nga ato të personave të ndaluar ose të arrestuar. Në këto raste mbajtja e personave në polici zgjat derisa çështja, për të cilën është kryer shoqërimi, verifikohet, por në çdo rast jo më shumë se 10 orë.

4. Për rastet e shoqërimeve për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, për dëbimet ose ekstradimet, procedurat dhe afatet e mbajtjes përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

5. Për shoqërimin dhe mbajtjen e personave në zyrat e policisë, punonjësi i policisë bën dokumentimin e veprimit dhe njofton menjëherë eprorin e vet ose organin e interesuar për sqarimin e çështjes.

6. Në të gjitha rastet e shoqërimit dhe mbajtjes në zyrat e policisë, merren parasysh kushtet personale dhe familjare të personit që shoqërohet.

Ligji nr.9749, datë 11.4.2007 “Për Policinë e Shtetit”, neni 102 “Kontrolli i identitetit”

1. Punonjësi i policisë bën kontrollin e identitetit të personave kur:

a) janë të pranishëm ose në afërsi të drejtpërdrejtë me vendngjarjen dhe kur janë dëshmitarë të mundshëm të veprës penale;

b) ekzekutohet një urdhër i organeve përkatëse;

c) kërkohen personat e dyshuar për cenim të rendit publik;

ç) ata hyjnë ose dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë;

d) për rrethana të kohës dhe vendit, dyshohet se personi është përfshirë në veprime të jashtëligjshme.

2. Për një identifikim të besueshëm të personit, punonjësi i policisë bazohet në dokumentet ligjore të identifikimit.

Ligji nr.9749, datë 11.4.2007 “Për Policinë e Shtetit”, neni 103 “Të dhënat në rastet e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit”

Për të regjistruar nga ana administrative të dhënat e personave të arrestuar, të ndaluar ose të shoqëruar, policia kryen këto veprime:

1. Në rast shoqërimi policia evidenton për çdo person të shoqëruar të dhënat për:

- a) gjeneralitetet;
- b) vendbanimin;
- c) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta;
- ç) punën që kryen;
- d) arsyet e shoqërimit;
- dh) orën, datën dhe vendin e shoqërimit;
- e) zyrën e policisë ku është kryer shoqërimi;
- ë) punonjësën e policisë, i cili ka kryer shoqërimin.

Këto të dhëna ruhen për shtatë vjet.

2. Në rast arrestimi apo ndalimi, policia evidenton për çdo person të arrestuar apo të ndaluar të dhënat për:

- a) gjeneralitetet;
- b) vendbanimin;
- c) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta;
- ç) punën që kryen;
- d) veprën penale për të cilën është arrestuar apo ndaluar;
- dh) hollësi për mënyrën e kryerjes së veprës penale, për të cilën është arrestuar apo ndaluar;
- e) orën, datën dhe vendin e arrestimit apo të ndalimit;
- ë) zyrën e policisë ku është mbajtur;
- f) punonjësën e policisë, i cili ka kryer arrestimin apo ndalimin.

3. Nga çdo person i arrestuar apo i ndaluar, në çdo rast, policia merr të dhënat e mëposhtme:

- shenjat e gjurmëve të gishtave dhe të pëllëmbëve të duarve;
- dy fotografi, një pamje ballore dhe një profil;
- mostrën për analizën e ADN-së, kur ekzistojnë kushtet teknike për konservimin dhe administrimin e kampioneve.

4. Punonjësi i policisë me gradë “Nënkomisar” apo më lart ose në rast emergjence dhe në mungesë të një punonjësi të tillë të policisë, punonjësi me gradën më të lartë mund të autorizojë përdorimin e forcës së arsyeshme për të realizuar kërkesat e pikës 3 të këtij neni, nëse personi i arrestuar apo i ndaluar kundërshton kërkesën.

5. Policia mund të marrë nga çdo person i shoqëruar të dhënat identifikuese, të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, nëse këto të dhëna nevojiten për të përcaktuar identitetin e personit. Nëse personi i shoqëruar nuk arrestohet apo ndalohet, të dhënat identifikuese të marra duhet të eliminohen pasi të përcaktohet identiteti i tij.

6. Punonjësit e policisë, të caktuar me detyrë në pikat e kalimit kufitar, mund të marrin shenjat e gjurmëve të gishtave për qëllime identifikimi nga çdo person që kalon kufirin, kur kryen ose dyshohet se ka kryer një vepër penale apo për qëllime administrative.

7. Për të gjithë personat e arrestuar apo të ndaluar, Policia e Shtetit krijon një bankë qendrore me të gjitha të dhënat e mbledhura, sipas pikës 2 të këtij neni dhe me të gjitha shenjat e gishtave, fotografitë dhe ADN-në, të marra sipas pikës 3 të këtij neni.

8. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka detyrimin të eliminojë të dhënat e identitetit, të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, të cilat i merren personit të arrestuar apo të ndaluar, mbi bazën e kërkesës së tij, nëse çështja penale në ngarkim të tij pushohet apo ai shpallet i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Ligji nr.9749, datë 11.4.2007 “Për Policinë e Shtetit”, neni 106 “Masat mbrojtëse”

1. Masat mbrojtëse merren ndaj personave të sëmurë mendorë, të dehurve, të droguarve ose ndaj personave me sëmundje ngjitëse. Në këto raste punonjësi i policisë e shoqëron personin në mjediset e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit apo e dorëzon te kujdestari apo personat përgjegjës.

2. Punonjësit e policisë marrin masat e nevojshme për mbrojtjen:

a) e personit, gjendja e të cilit tregon qartë se nuk mund të kontrollojë veprimet dhe sjelljen e tij dhe për këtë arsye mund t'i shkaktojë dëmtime fizike apo rrezikim të jetës së tij apo të të tjerëve. Zbatimi i masës në mjediset e policisë vazhdon për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më shumë se 10 orë;

b) e të miturit që nuk mbikëqyret më ose është larguar nga prindi apo kujdestari i tij, duke ia rikthyer kujdestarit apo duke e dërguar në qendrat e përkujdesit për të miturit, sipas afatit të përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike.

3. Për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, punonjësi i policisë mund të bëjë kontrollin dhe këqyrjen fizike të këtyre personave.

Ligji nr.9749, datë 11.4.2007 “Për Policinë e Shtetit”, neni 107 “Trajtimi i të shoqëruarve”

1. Nëse një person shoqërohet sipas nenit 101 të këtij ligji, atëherë ai duhet të njoftohet menjëherë për arsyet e shoqërimit.

2. Personit të shoqëruar duhet t'i jepet menjëherë mundësia për të njoftuar një të afërm ose një person të cilit ai i beson. Nëse i shoqëruari nuk është në gjendje të ushtrorë të drejtat e tij si më sipër dhe nëse nuk bie ndesh me vullnetin e personit, Policia njofton kryesisht personat e sipërpërmendur. Kur i shoqëruari është i mitur, atëherë në çdo rast njoftohet menjëherë personi përgjegjës për mbikëqyrjen e tij. E njëjta gjë vlen edhe për të rriturit, për të cilët është caktuar një kujdestar.

3. Femrat dhe meshkujt shoqërohen në mjedise të veçara. Të miturit shoqërohen në mjedise të veçanta nga ato të të rriturve, personit që i atribuohet vepra penale.

Ligji nr.10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, neni 13 “Personat që kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë juridike”

1. Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë personat, të cilët:

a) kërkojnë të mbrohen me avokat në procesin penal në të gjitha fazat e tij dhe, për shkak të pamundësive financiare, nuk kanë mundur të zgjedhin një avokat apo kanë mbetur pa të;

b) kanë nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile ose administrative, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për ta paguar këtë ndihmë juridike apo çështjet janë tepër komplekse, nga ana e përmbajtjes dhe e procedurës. Në këtë rast, personi, që ta përfitojë ndihmën juridike, duhet të vërtetohet se përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t'u përfshirë në to.

2. Ndihmën juridike e përfitojnë edhe të miturit, për të cilët mbrojtja në procedimin penal dhe në gjykim është e detyrueshme me ligj.

3. Ndihma juridike mund të kërkohej para, gjatë dhe pas zhvillimit të procesit gjyqësor.

4. Personi, i cili përfiton ndihmë juridike, ka detyrimin të bashkëpunojë me avokatin, që siguron ndihmën juridike, të japë informacion të vërtetë, për të cilin është kërkuar ndihma juridike, si dhe të sigurojë në kohë çdo informacion për rrethanat dhe kushtet, që kanë ndryshuar shkakun e dhënies së ndihmës.

5. Moszbatimi i pikës 4 të këtij neni nga personi, që përfiton ndihmën juridike për çështjet civile ose administrative, përbën shkak për ndërprerjen e menjëhershme të përfitimit të kësaj ndihme juridike.

Kodi i Procedurës Penale, neni 61 “Padi civile në procesin penal”

1. Ai që ka pësuar dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit.

Ligji nr.10 173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, neni 2 “Fusha e veprimit”

Dispozitat e këtij ligji janë të zbatueshme në kuadër të procedimeve penale për krime të kryera me dashje, për të cilat ligji parashikon dënim me burgim jo me pak se 4 vjet, në minimum. Rrezikshmëria e këtyre krimeve dhe e autorëve, duhet të jetë e tillë, që të justifikojë kryerjen e shpenzimeve të nevojshme për mbrojtjen e një ose disa personave.

Ligji nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, neni 37 “Fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit”

1. Të ardhurat e përfituara nga zbatimi i këtij ligji, për vitet financiare 2009-2010, në masën

50 për qind, do të shërbejnë për ngritjen e fondit të posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor. Pas kalimit të këtij afati, fondi i posaçëm dhe masa e tij përcaktohen në legjislacionin buxhetor.

2. Ky fond shërben për:

a) përmirësimin e funksionimit të drejtësisë penale, duke destinuar pasuritë në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Ministrisë së Drejtësisë;

b) përmirësimin e hetimeve paraprake penale të krimit të organizuar dhe zhvillimin e programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve e të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet e rendit publik;

c) dhënien e ndihmës viktimave të krimit të organizuar dhe të dhunës, si dhe nxitjen e programeve sociale për këto kategori, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet sociale.

3. Përveç institucioneve qendrore, përfitues të financimit të projekteve për parandalimin e kriminalitetit mund të jenë:

a) njësitë e qeverisjes vendore, ku ndodhen pasuritë e paluajtshme të konfiskuara;

b) organizatat jofitimprurëse, që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre rehabilitimin social, kulturor e shëndetësor të shtresave në nevojë, veçanërisht atyre të prekura apo të rrezikuara nga krimi, përfshirë organizatat dhe qendrat terapeutike, qendrat e riaftësisimit dhe të kurimit të përdoruesve të substancave narkotike, si dhe qendrat e asistencës e të rehabilitimit të viktimave të trafikut të qenieve njerëzore, që në tri vitet e fundit nga paraqitja e kërkesës, zhvillojnë veprimtari të tilla.

4. Kërkesat për financimin e projekteve, sipas këtij neni, verifikimi dhe përgatitja e dokumentacionit për mendim në Komitetin Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar, si dhe ndjekja e zbatimit të tyre bëhen nga strukturat e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

5. Ministri i Financave, mbështetur në rekomandimin e Komitetit Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar, me urdhër, përcakton financimin e projektit dhe mënyrat e përdorimit të fondit të vënë në dispozicion të kërkuarit.

6. Pjesa e fondit, e destinuar sipas pikës 2 të këtij neni, nuk mund të përdoret për shpërblime të funksionarëve të institucioneve përfituese.